



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 40/46 Prot.

Tiranë më, 31/10/2024

V E N D I M

Nr. 51 datë 31.10.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Denisa Sina	Kryesues
Suela Bulku	Relator
Arben Sefaj	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Ledjana Azemaj, më datë 21.10.2024, ora 10:15, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Luan Zylal Mema, me funksion Zëvendës drejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të relatores së çështjes, Znj. Suela Bulku, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Luan Mema, i cili në seancë dëgjimore kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi **Z. Luan Mema** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023 si “Zëvendëdrejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorin Vendore të Policisë Berat”.
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Luan Mema**, iu nënshtroi procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. *** datë 14.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku (Relatore), Znj. Denisa Sina (Kryesuese) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. ***, datë 14.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Luan Mema**.
6. Relatori i çështjes, Znj. Suela Bulku, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 14.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë

e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Më datë 17.07.2023, janë dërguar formularët e administruar nga ana e relatorit e konkretisht:

- ✓ Me shkresën nr. ***, prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të pasurisë pranë ILDKPKI.
- ✓ Me shkresën nr. *** prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të aftësive profesionale.
- ✓ M shkresën nr. *** prot. datë 17.07.2023, është dërguar formulari i deklaramit të kontrollit të figurës.

8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 19.07.2023, duke shprehur se **nuk është** në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

9. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

- ✚ vlerësimin e pasurisë;
- ✚ kontrollin e figurës;
- ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.

12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.

- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndyshuar
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- + Deklarata e Pasurisë,
- + Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- + Formulari i Vlerësimit Profesional
- + Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,
- + Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI
- + Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP
- + Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH
- + Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- + provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- + ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, më datë 15.10.2024, pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Luan Mema, me Vendimin nr. ***, datë 15.10.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Luan Zylal Mema**
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

- + Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;
- + Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;

- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të

Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 17.10.2024, trupa e vlerësimit njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 21.10.2024, në orën 10:15, Salla e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE.

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Luan Mema, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 21.10.2024, subjekti i vlerësimi z. Luan Mema, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 21.10.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Subjekti i vlerësimit z. Luan Mema, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur ka qenë e nevojshme, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

- ✚ Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- ✚ Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Luan Mema** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve ligjore. Formulari i Pasurisë ka nr. *** indexi, viti 2023.
- ✚ Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

- ✚ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- ✚ Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarameteve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameteve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:

ILDKPKI, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raportin nr. ***, datë 12.04.2024, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Luan Mema, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, është konstatuar se:

- a) **deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;**
- b) **ka mosdeklarime dhe mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë e personit të lidhur;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- LUAN MEMA

DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

1. **Truall** me sip. 242 m2, nr. pasurie *** ZK ***, Rr. "****", Durrës. Vlera 342.000 lekë, sipas faturës datë 18.02.2005. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: paguar nga kursimet e familjes 107.000 lekë dhe 235.000 lekë me Bono privatizimi.

1.1 **Godinë banimi** 2 kate, me sip. totale 287.49 m2, vlera 5.314.806 lekë, sipas raportit të vlerësimit datë 08.02.2023, me nr. pasurie *** ZK ***, Lagjja ***, Rruga "****" Durrës. Ndërtimi i shtëpisë ka filluar në vitin 1995 dhe nuk ka përfunduar akoma. Periudha 1995 - 2005, ndërtim karabina dhe në periudhat në vazhdim punimet e brendshme. Vlera 5.314.906 lekë. Pjesë takuese 100%.

Burimi i krijimit:

Të ardhura nga zhvillimi i aktivitetit privat Albmedicin shpk., me vendim gjykate nr. *** datë 20.06.1995, kod fiskal ***, Gramsh. Shuma 2.050.000 lekë. Kredi nga Procredit Bank, shuma 170.000 lekë, datë 12.01.2005.

Kredi nga Raiffeisen Bank, shuma 400.000 lekë, datë 21.10.2005.

Kredi nga Fondi Besa, shuma 300.000 lekë, datë 28.07.2008.

Kredi nga Procredit Bank, shuma 400.000 lekë, datë 10.12.2008.

Të ardhura nga qiraja e banesës sipas kontratës nr. *** datë 29.07.2008. Shuma 1.100.000 lekë. Kursime dhe të ardhura familjare, shuma 694.906 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 15.09.2014, të pasurisë truall me sip. 242 m2, nga kjo ndërtesë me sip. 127 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në pronësi të Luan Mema, ndodhur në Durrës.
- Harta treguese e regjistrimit të pasurisë me nr. ***, ZK ***, në pronësi të Luan Mema.
- Leje legalizimi nr. ***, datë 30.09.2010, dhënë shtetasit Luan Mema, për objektin "godinë banimi 2 kate", sipas vendimit të KRRT, nr. ***, datë 27.10.2007. Objekti është regjistruar me nr. pasurie ***, ZK ***, sip. parcele ndërtimore 242 m2, sip. ndërtimit 127 m2, 2 kate mbi tokë.
- Ortofoto dixhitale e pasurisë nr. ***, ZK ***, Durrës, shoqëruar me genplanin dhe planimetrinë e objektit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 06.12.2010, të pasurisë truall me sip. 242 m2, nga kjo ndërtesë me sip. 127 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në pronësi të Luan Mema, ndodhur në Durrës.
- Kontratë e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore (shitje me rezerve e pronës), nr. *** rep. nr. *** kol., datë 05.08.2010, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Drejtoria Rajonale e Aluiznit Durrës dhe palës blerëse Luan Mema, të parcelës ndërtimore me sip. 242 m2, nr. ***, ZK ***,

në bazë të vendimit nr. ***, datë 12.11.2008. Çmimi i shitjes 342.000 lekë. Pala blerëse deklaroi se ka bërë pagesën e menjëhershme dhe nuk e ka përfituar zbritjen prej 20%. Pagesa është në vlerën prej 107.000 lekë, datë 30.06.2010 dhe vlerën 235.000 lekë, në Bono Privatizimi, me mandatin datë 30.06.2010, në Bankën Credins. Bashkëlidhur:

- Formulari i pagesës së parcelës ndërtimore, datë 25.05.2010, i lëshuar nga ALUIZNI Durrës, për Luan Mema. Vlera totale 342.000 lekë. Pagesë 107.000 lekë.
 - Mandat urdhër xhirimi bankar, datë 30.06.2010, Luan Mema shlyen shumën 107.000 lekë, në favor të ALUIZNI Durrës.
- Raport vlerësimi datë 11.02.2023, për koston e ndërtimit të banesës me 2 kate, pasuria ***, ZK ***, adresa: Lagja nr. ***, Rruga "****", Bashkia Durrës. Porositës Luan Mema, vlerësues Ing. L.Sh. Sipas raportit, vlerësimi i pasurisë është kryer për vlerën e koston së ndërtimit, referuar vlerave të vitit 2005 (26.373 lekë/m²). Duke qenë ndërtim i realizuar në ekonomi nga familja e Luan Memës, janë zbritur shpenzimet e pakryera (tvsh 20%; fitim 10% dhe shpenzime të përgjithshme 8%), duke përcaktuar kështu kosto për njësi, të mbetur në vlerën 18.499,5 lekë/m². Mbi bazën e sipërfaqes totale të ndërtimit dhe çmimit për m², vlerësuesi ka përcaktuar vlerën totale të koston së ndërtimit, shumën prej 5.314.906 lekë. Bashkëlidhur raport vlerësimit, ndodhen foto të objektit.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 13.04.2018, nga DRT Elbasan drejtuar shtetasit Luan Mema, lidhur me aktivitetin e zhvilluar prej tij në Degën Tatimore Gramsh, konfirmohet kodi fiskal i aktivitetit tregtar "Alb Medicin" shpk, me nr. ***, regjistruar më datë 20.06.1995, me vendimin e gjykatës nr. **. Adresa e veprimtarisë: Lagjja "****", Gramsh. Bashkëlidhur ndodhet licenca e aktivitetit tregtar, lëshuar nga Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, Komisioni i Dhënies së Licencave Profesionale.
- Kontratë kredie nr. ***, nënshkruar në datë 12.01.2005, ndërmjet kredidhënësit Procredit Bank, kredimarrësit Luan Mema dhe debitorit solidar Ardiana Mema të shumës 170.000 lekë. Destinacioni i kredisë do të jetë për "working capital". Shlyerja e kredisë do të jetë në 18 këste mujore.
- Kontratë kredie bankare, nënshkruar në datë 21.10.2005, ndërmjet kredidhënësit Raiffeisen Bank, kredimarrësve Luan Mema e Ardiana Mema dhe dorëzanësit M.M, të shumës 400.000 lekë. Destinacioni i kredisë do të jetë për "mobilim". Afati i shlyerjes së kredisë 36 muaj.
- Kontratë huaje (me garanci peng) nr. ***, kol., nr. *** rep., datë 28.07.2008, palë huadhënëse Fondi Besa, palë huamarrëse Luan Mema, garanti Ardiana Mema, të kredisë me vlerë 300.000 lekë. Afat shlyerje 36 muaj. Garancitë: të gjitha pajisjet elektroshtëpiake, si dhe mallin gjëndje, vlerësuar sipas çmimit të tregut në shumën 450.000 lekë.
- Kontratë kredie nr. ***, nënshkruar më datë 10.12.2008, ndërmjet kredidhënësit Procredit Bank, kredimarrësit Luan Mema dhe debitorit solidar Ardiana Mema, të shumës 400.000 lekë. Destinacioni i kredisë do të jetë për "kapital të trupëzuar". Afati i shlyerjes së kredisë 36 muaj.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.07.2008, nënshkruar ndërmjet qiradhënësit Luan Mema dhe qiramarrësit Qendra e Formimit Profesional dhe Rehabilitimeve Durrës, të një objekti 2 katësh, në proces legalizimi, me sip. ndërtimi 112.7 m², gjithsej rreth 250 m². Vlera e qirasë mujore 70.000 lekë/muaj. Afati i qirasë 5 vite, nga data 01.10.2008 deri në 30.09.2013. Qiraja për pesë muajt e parë do të paguhet paradhënie nëpërmjet BKT. Palët bien dakort që tatimi mbi burimin e të ardhurave mbi pronën, do të paguhet përgjysëm.

- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 22.01.2013, e cila vendosi detyrimin e të paditurit Qendra e Formimit Profesional dhe Rehabilitimeve “Ne për Durrësin”, t’i paguajë paditësit Luan Mema, shumën prej 2.021.982 lekë, si detyrim kontraktor i papaguar për periudhën 01.10.2008 - 31.12.2012, si dhe shumën prej 132.000 lekë, si detyrim për pagimin e tatimit në burim i papaguar. Gjithashtu, është vendosur zgjidhja e kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol, datë 29.07.2008.
- ✚ **ASHK (online)**, konfirmon pasurinë nr. ***, ZK ***, por nuk përcakton emërtimin me të cilin është regjistruar.
- ✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Durrës**, me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2023, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon kredinë në emër të shtetasit Luan Mema, disbursuar në datë 24.11.2005, në vlerën 400.000 lekë dhe likuiduar totalisht më datë 26.02.2008.
- ✚ **Procredit Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema ka përfituar kreditë në vlerën 170.000 lekë, datë 12.01.2005, si dhe në vlerën 400.000 lekë, datë 11.12.2008, vlera të cilat janë tërhequr cash. Kreditë rezultojnë të dyja të likuiduara, përkatësisht në datat 06.07.2006 dhe 02.08.2011.
- ✚ **Fondi Besa**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.08.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema, ka përfituar kredi në datë 28.07.2008, me vlerë 300.000 lekë, mbyllur më 17.03.2011.
- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron, se në vitin 1995 ka filluar punimet për ndërtimin e godinës 2 katëshe, me sip. 287.49 m2 dhe truall me sip. 242 m2, dhe nga viti 1995 - 2005 janë kryer punimet si themelet, kollona, karabinaja, muret anësore, si dhe suvatimet kanë qënë në vijimësi. Në vitin 2008 ka marrë një paradhënie nga qiramarrësi, kjo referuar edhe kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.07.2008, ku ka bërë punime, si shtrimet me pllaka dhe ndarjet me kartonxhes të katit të parë, e cila u përshtat sipas kërkesës së qiramarrësit, si dhe më vonë, për riparime elektrike hidraulike dhe mirëmbajtje të godinës së banimit. Të ardhurat nga qiraja të vitit 2008, janë përdorur për rregullimin dhe sistemimin e objektit për qiramarrësin, pasi objekti s'ka qënë i përfunduar në vitin 2005. Aktualisht punimet në godinën e banimit janë ende të papërfunduara (ka ngelur pa përfunduar shtrimi me pllaka i shkallëve dhe mbulimin e kafazit të shkallëve, termoizolimin dhe hidroizolimin e tarracës, si dhe suvatimet anësore të dy kateve, pasi është suvatuar vetëm pjesa ballore e objektit të banimit). Në lidhje me dokumentacionin e aktivitetit tregtar Albmedicin, nuk disponon fatura dhe bilance financiare, pasi kanë kaluar mbi 26 vite. Aktiviteti tregtar ka qënë i regjistruar në Degën e Tatimeve Gramsh, kjo referuar shkresës kthim përgjigje, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, nr. *** prot., datë 13.04.2018. Nga viti 2001 deri në vitin 2005, ka banuar në një dhomë të pa shtruar me pllaka, ku mobilimin pjesërisht e ka sjellë nga Gramshi, ndërsa një pjesë është blerë në Durrës, vlera e shpenzuar

për mobilim ka qënë 130.000 lekë. Nga viti 2005 deri në vitin 2018, ka shpenzuar vlerën 300.000 lekë.

Deri në vitin 1993 ka jetuar në Gramsh, tek shtëpia e babait të tij Zylal Mema. Në vitet 1994 - 2001 ka jetuar në dy dhoma të cilat i ka përshtatur për banim, tek Depoja e Duhanit (Ish Ndërmarrja e Grumbullimit), Lagjja “Agjensia” në Gramsh, të cilat ja dha Bashkia Gramsh si i pastrehë.

Pas tërmetit të vitit 1997, Bashkia Gramsh shpalli godinën në funksion jo të banueshëm. Ka ikur nga Gramshi në vitin 2001. Sot kjo pronë është e Bashkisë Gramsh.

Në vitin 2001 ka hyrë për të banuar në shtëpinë e tij në Durrës, në dy dhoma, pjesërisht të rregulluara.

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti ri-sqaron, në pyetjen e shpenzimeve të përgjithshme të mobilimit, se për mobilimin e shtëpisë, në vitet 1994 - 2001, ka investuar vlerën 118.000 lekë. Nga viti 2001 deri në 2018, vlerën 287.000 lekë. Në vitin 2018 ka blerë një televizor me kredi, në vlerën 99.990 lekë.
- **Në proces verbalin e datës 20.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, subjekti sqaron, se data e deklaruar për blerjen e truallit datë 18.02.2005, i referohet kërkesës për legalizim të objektit, ndërsa blerja e tij është kryer në vitin 2010, sipas dokumentacionit të paraqitur. Gjatë periudhës së qiradhënies ka banuar në të njëjtin objekt, kjo në kushtet kur është dhënë me qira vetëm një pjesë e tij dhe objekti është me dy hyrje të ndryshme.
Konfirmoi se vlera e shpenzuar për mobilimin e objektit ishte aq sa ka deklaruar në pyetjen specifike të kryer për këtë kategori shpenzimesh dhe konkretisht në vlerën totale prej 405.000 lekë, si dhe elektroshtëpiake në vlerën 99.990 lekë.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 25.01.2024, i Bashkisë Gramsh, për shtetasin Luan Mema, i cili rezulton të ketë qënë përfitues me statusin “familje e pastrehë”, i një objekti të përdorur si njësi banimi, në godinën e ish depove të duhanit, pronë e Bashkisë Gramsh. Ky objekt, prej vitit 1998 është shpallur i pabanueshëm dhe familjet nuk janë pajisur me dokument pronësie. Bashkëlidhur akti dhe relacioni teknik. Referuar listës së familjeve të dëmtuara nga tërmeti bashkëlidhur shkresës, ku rezulton një përfitim në formën e ndihmës financiare prej 550.000 lekë, në favor të shetasit Luan Mema.
- Kontrata e kredisë, nënshkruar nga Luan Mema, në datë 27.12.2018, pranë Raiffeisen Bank me vlerë 99.990 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë për blerje televizori. Afat shlyerje 24 muaj. Bashkëlidhur faturë tatimore blerje pranë shoqërisë Neptun shpk, të një televizori, datë 27.12.2018, vlerë 99.990 lekë.

Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Pasuria truall sip. 242 m² + godinë banimi 2 kate me sip. totale 287.49 m² në Rr. “****”, Durrës, është ndërtuar nga subjekti gjatë viteve 1995 - 2005 dhe përfituar me anë të legalizimit në vitin

2010. Subjekti deklaron se deri në vitin 2005 ka përfunduar procesi kryesor i ndërtimit të objektit si karabina dhe mure anësore, por ka vazhduar të investojë në objekt edhe pas vitit 2005. Referuar deklaramit të subjektit dhe raport vlerësimit të paraqitur, janë shpenzuar gjithsej për ndërtim, rreth 5.314.906 lekë, sipas referencave të kostove të ndërtimit për vitin 2005, si dhe për mobilim shumë rreth 515.000 lekë. Burimi financiar për ndërtimin e objektit, deklarohet në shumën rreth 2.050.000 lekë, nga zhvillimi i një aktiviteti tregtar, i cili dokumentohet se ka qënë i regjistruar në Degën e Tatimeve Gramsh, por nuk ka të dhëna financiare lidhur me realizimin e shumës; 1.300.000 lekë, nga kreditë bankare, të cilat konfirmohen nga sistemi bankar; 1.100.000 lekë, nga qiradhënia e një pjese të këtij objekti në vitin 2008, të cilat janë dokumentuar me anë të kontratës së qirasë dhe vendimit gjyqësor, si dhe diferenca rreth 700.000 lekë, nga të ardhura e kursime personale.

- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar, shpjegimet e dhëna dhe konfirmimet nga sistemi bankar e financiar. ASHK nuk e konfirmon pasurinë. Rezultojnë shpenzime mobilimi ndër vite në vlerën totale rreth 515.000 lekë.**

Sa me sipër rezulton:

- ❖ **Dokumentacion jo i plotë justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat, në shumën 2.050.000 lekë, gjatë viteve 1995 - 1998, përdorur si burim për ndërtimin e objektit të banimit me 2 kate dhe sip. totale 287.49 m2, Durrës, për të cilat është i aplikuashëm neni 32, pika 1.1, i ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Cështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.**
2. **Tokë arë** me sip. 12.000 m2, në pronësi të familjes së Z.M, Gramsh, me nr. të aktit ***, në bazë të ligjit nr. 7501. Anëtar i familjes, sipas certifikatës për gjendjen familjare, më datë 01.08.1991. Pjesë takuese 25%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, i jepet familjes së Z.M, sip. toke bujqësore gjithsej 12.000 m2, në Gramsh-fshat.
- Certifikatë familjare, lëshuar në bazë të regjistrimit themeltar të vitit 1974, në fshat Gramsh, e familjes së shtetasit Zylal Mema dhe tre antarëve të familjes, gjendje në datën 01.08.1991.
- Dokumentacion për regjistrimin e pasurisë Bashkëlidhur:
- Certifikata për vërtetim pronësie datë 08.09.2020, të pasurisë arë, me sip. 2.100 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në emër të Z.M, në Gramsh Fshat. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit.
 - Certifikata për vërtetim pronësie datë 08.09.2020, të pasurisë arë me sip. 2.400 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në emër të Z.M, në Gramsh Fshat. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit.

- Certifikata për vërtetim pronësie datë 08.09.2020, të pasurisë arë me sip. 2.300 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në emër të Z.M, në Gramsh Fshat. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit.
- Certifikata për vërtetim pronësie, datë 08.09.2020, të pasurisë arë me sip. 1.500 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në emër të Z.M, në Gramsh Fshat. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit.
- Certifikata për vërtetim pronësie datë 08.09.2020, të pasurisë arë me sip. 3.200 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***, në emër të Z.M, në Gramsh Fshat. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese e regjistrimit.

✚ **ASHK, Zyra Vendore Gramsh**, me shkresën nr. *** prot., datë 15.09.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema, referuar gjendjes familjare datë 01.08.1991, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, gjithsej 4 anëtarë, kanë përfituar gjithsej 12.000 m2 tokë, nga kjo arë me sip. 11.700 m2 dhe truall me sip. 300 m2, sipas AMTP nr. ***, datë 28.03.1992.

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti deklaron se në pasurinë tokë are me sip. 12.000 m2, të familjes Z.M në Gramsh, nuk ka bërë asnjë investim.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK. Pasuria është e regjistruar në emër të babait të subjektit Zylal Mema, përfituar nga Ligji 7501.**

3. **Blerje automjeti tip IFA, 5 ton**, në korrik të vitit 1995. Vlera 180.000 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga aktiviteti privat Albmedicin shpk.

3.1 **Shitje automjeti tip IFA 5 ton**, në tetor të vitit 1995, sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 02.10.1995. Vlera 500.000 lekë. Pjesë takuese 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

➤ Kontratë shitblerje (pasurie të luajtshme) nr. *** rep., datë 02.10.1995, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Luan Mema dhe palës blerëse A.B, të automjetit tip IFA 5 ton, prodhim i vitit 1980, mjet i cili është blerë nga shitësi me kontratën e shitjes datë 11.10.1994. Cmimi i shitjes 500.000 lekë.

✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***, datë 14.08.2023, nuk e konfirmon automjetin në emër të Luan Mema.

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, lidhur me vlerën e shitjes së automjetit tip IFA 5 ton, e cila është më e lartë se ajo e blerjes, subjekti deklaron se pas blerjes ka kryer shërbime gjenerike dhe lyerje, si dhe mbulesën e karrocisë. Referuar kërkesës së tregut, e ka shitur me çmimin e mësipërm.

✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna. DPSHTRR, nuk e konfirmon automjetin. Automjeti është blerë në vitin 1994 dhe shitur në vitin 1995.**

4. **Blerje automjet tip Audi 80**, në vitin 1994. Vlera 120.000 lekë. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: kursime dhe të ardhurat familjare.
- 4.1 **Shitje automjeti tip Audi 80**, sipas kontratës familjare, datë 27.10.1995. Vlera 300.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje datë 27.10.1995, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Luan Mema dhe palës blerëse Q.L, të automjetit tip Audi 80, mjet i cili është blerë nga shitësi me kontratën e shitjes datë 10.07.1995. Çmimi i shitjes 300.000 lekë.
- ✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***, datë 14.08.2023, nuk e konfirmon automjetin në emër të Luan Mema.
- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, lidhur me vlerën e shitjes së automjetit, e cila është më e lartë se ajo e blerjes, subjekti deklaron se, pasi i ka kryer shërbimet gjenerike dhe motorike, e ka shitur në vlerën e mësipërme, sipas kërkesës së tregut.
- ✓ **Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna. DPSHTRR nuk e konfirmon automjetin. Automjeti është blerë në korrik 1995 dhe shitur në tetor 1995.**

5. **Blerje automjeti tip Fiat**, në vitin 2011. Vlera 110.000 lekë. Burimi i krijimit: nga të ardhurat nga qiraja e banesës, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.07.2008.
- 5.1 **Shitje e automjetit tip Fiat**, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2013. Vlerë 100.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Luan Mema dhe palës blerëse L.B, të automjetit tip Fiat 182, vit prodhimi 1999. Çmimi i shitjes 100.000 lekë.
- ✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***, datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema ka pasur në pronësi të tij, automjetin me targë ***. Bashkëlidhur:
- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.10.2011, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Sh.L dhe palës blerëse Luan Mema, të automjetit tip Fiat Brava, targë ***, nr. shasie ***. Çmimi i shitjes 200.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Luan Mema dhe palës blerëse L.B, të automjetit tip Fiat 182, vit prodhimi 1999, targë ***, nr. shasie ***. Çmimi i shitjes 100.000 lekë.

- Në kthim përgjigjen nr. ***, datë 20.06.2024, pranë Trupës së Vlerësimit, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, se lidhur me vlerën e blerjes së automjetit tip Fiat, nuk ka pasur fizikisht kontratën e blerjes së automjetin për të parë çmimin real të blerjes, por mbante mend se e kishte blerë në vlerën 110,000 lekë, kjo pasi kanë kaluar mbi 12 vjetë.

Gjithashtu deklaroi në përgjegjësinë e tij, se burimi i krijimit të të ardhurave ka qënë nga qiraja e banesës, sipas kontratës noteriale nr.rep. ***, nr.kol, ***, datë 29.07.2008, dhe nga kursimet familjare të punës së subjektit dhe bashkëshortes së tij. Sqaron se nuk ka pasur asnjë qëllim për të fshehur dhe mosdeklaruar çmimin real por thjeshtë një harresë.

- ✓ **DPSHTRR konfirmon vlerën e blerjes së automjetit prej 200.000 lekë. Automjeti është shitur në vitin 2013, në vlerën 100.000 lekë.**

6. **Blerje automjeti tip Ford Mondeo**, në vitin 2014. Vlera 1.300 euro. Burimi i krijimit: nga të ardhurat e shitjes së mjetit Fiat, si dhe kursime familjare nga qiraja e banesës.

6.1 **Shitje makine Ford Mondeo**, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.02.2018. Vlera 1.300 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.02.2018, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Luan Mema dhe palës blerëse Gj.L, të automjetit tip Ford Mondeo, vit prodhimi 2002, targë ***. Çmimi i shitjes 1.300 euro.

✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***, datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema ka pasur në pronësi të tij automjetin me targë ***. Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol. datë 21.10.2014, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Sh.P dhe palës blerëse Luan Mema, të automjetit tip Ford Mondeo, targë ***. Çmimi i shitjes 250.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje nr. 230 rep., nr. 151 kol., datë 26.02.2018, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Luan Mema dhe palës blerëse Gj.L, të automjetit tip Ford Mondeo, vit prodhimi 2002, targë ***. Çmimi i shitjes 1.300 euro, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- Në kthim përgjigjen nr. 40/27, datë 20.06.2024, pranë Trupës së Vlerësimit, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, se lidhur me vlerën e blerjes së automjetit tip Ford, është lapsus në deklaram, pasi në kolonën e blerjes së automjetit është vendosur në vlerën 1.300 euro, pasi ka qënë vlera e shitjes ajo në shumën 1.300 euro.

- ✓ **DPSHTRR konfirmon vlerën e blerjes së automjetit prej 250.000 lekë. Automjeti është shitur në vitin 2018, në vlerën 1.300 euro.**

7. **Llogari Raiffeisen Bank**, me gjendje në datën 01.03.2023. Vlerë 46.935 lekë pa overdraft. Vlera me overdraft 176.935 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Luan Mema, me gjendje në datën 06.03.2023, në vlerën 114.667 lekë dhe overdraft me balance 130.000 lekë.
- ✓ **Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqities së tyre në dy data të ndryshme.**
8. **Llogari në Euro**, në Raiffeisen Bank, vlerë 0 euro.
- ✚ **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetasit Luan Mema, me gjendje në datën 06.03.2023, në vlerën 0 euro.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**
9. **Llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank**, me gjendje në datën 01.03.2023, vlera 0 lekë.
- ✚ **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Luan Mema me gjendje në datën 06.03.2023 në vlerën 0 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank.**
10. **Llogari bankare në BKT**, me gjendje në datën 01.03.2023, në vlerën 0 lekë.
- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetasit Luan Mema me gjendje në datën 06.03.2023, në vlerën 0 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

11. Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, nga data 15.08.2022 e në vazhdim. Shuma e të ardhurave 698.520 lekë.
12. Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, periudha 19.05.2021 - 14.08.2022. Shuma e të ardhurave 1.084.681 lekë.
13. Të ardhura nga punësimi në Departamentin e Sigurisë Publike dhe DPPSH, periudha 05.11.2014 - 18.05.2021. Shuma e të ardhurave 6.801.471 lekë.
14. Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, periudha 24.10.2013 - 04.11.2014. Shuma e të ardhurave 673.983 lekë.

15. Të ardhura nga punësimi në Njësinë Administrative nr.6 Durrës, periudha 01.02.2010 - 23.10.2013. Shuma e të ardhurave 2.371.969 lekë.
16. Të ardhura nga punësimi në Bashkinë Durrës, periudha 01.10.2008 - 31.01.2010. Shuma e të ardhurave 72.077 lekë.
17. Të ardhura nga reforma për pagesë kalimtare në polici, periudha 16.09.2006 - 31.07.2009. Shuma e të ardhurave 1.286.862 lekë.
18. Të ardhura nga punësimi në Komisaratin e Policisë Tropojë, periudha 20.02.2006 - 15.09.2006. Shuma e të ardhurave 329.130 lekë.
19. Të ardhura nga punësimi në Repartin Special për Kufirin dhe Migracionin Delta Vlorë, periudha 01.08.2001 - 31.03.2005. Shuma e të ardhurave 1.279.340 lekë.
20. Të ardhura nga qëndrimi në dispozicion të Ministrisë së Brendshme, periudha 24.10.2000 - 31.07.2001. Shuma e të ardhurave 75.000 lekë.
21. Të ardhura nga punësimi në Komisaratin e Policisë Kurbin, DVP Lezhë, periudha 23.5.2000 - 24.10.2000. Shuma e të ardhurave 101.470 lekë.
22. Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, periudha 01.11.1998 - 22.05.2000. Shuma e të ardhurave 319.700 lekë.
23. Të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, periudha 16.11.1997 - 30.11.1998. Shuma e të ardhurave 234.532 lekë.
24. Të ardhura nga punësimi në Komisaratin e Policisë Gramsh, periudha 15.08.1997 - 11.11.1997 dhe 16.06.2005 - 19.2.2006. Shuma e të ardhurave 318.571 lekë.
25. Të ardhura nga aktiviteti privat nga Albmedicin shpk, krijuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 20.06.1995, me objekt “grumbullim tregtim të bimëve medicinale”. Aktiviteti ka pasur veprimtari nga data 20.06.1995 deri më 31.12.1998. Shuma e të ardhurave 2.847.432 lekë.
26. Të ardhura nga punësimi pranë Ndërmarrjes së Grumbullim Përpunimit Gramsh, periudha 16.08.1993 - 24.06.1995. Paga mujore 6.735 lekë. Vërtetimin nuk e disponoj, pasi nuk ekziston më kjo ndërmarrje. Shuma e të ardhurave 148.170 lekë.
27. Të ardhura nga funksioni si Inspektor i Policisë Financiare, në Degën e Policisë Financiare Gramsh, për periudhën 01.04.1991 - 15.08.1993. Paga mujore 2.570 lekë. Vërtetimin nuk e disponoj, pasi nuk gjenden dokumenta. Shuma e të ardhurave 41.120 lekë.
28. Të ardhura nga funksioni si Inspektor në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Gramsh, për periudhën 01.11.1991 - 01.04.1992. Paga mujore 1.200 lekë. Vërtetimin nuk e disponoj, pasi nuk ekziston më si institucion. Shuma e të ardhurave 6.000 lekë.
29. Të ardhura nga punësimi në Ndërmarrjen Pyjore Gramsh, periudha 20.09.1988 - 31.10.1991. Paga mujore 680 lekë. Vërtetimin nuk e disponoj, pasi nuk ekziston më si institucion. Shuma e të ardhurave 25.160 lekë.
30. Të ardhura nga dhënia me qira e banesës, kati i parë, Qendrës së Formimit Profesional dhe Rehabilitimeve Durrës. Shuma e të ardhurave 1.564.000 lekë.
31. Të ardhura nga dhënia me qira e banesës, kati i parë, Perry Al shpk. Periudha prill – qershor 2008. Shuma e të ardhurave 75.000 lekë.
32. Të ardhura nga shitja e makinës tip IFA 5 ton, blerë 180.000 leke, shitur 500.000 lekë. Shuma e të ardhurave 320.000 lekë.
33. Të ardhura nga shitja e automjetit Audi 80, blerë në vlerën 120.000 lekë, shitur 300.000 lekë. Shuma e të ardhurave 180.000 lekë.

34. Të ardhura nga angazhimi personal, si personel akademik në Universitetin A. Moisiu Durrës, viti akademik 2021 - 2023. Shuma e të ardhurave 52.476 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Luan Mema, gjatë periudhës; 15.08.1997 - 11.11.1997, në shumën 39.188 lekë; 16.06.2005 - 19.02.2006, në shumën 279.383 lekë dhe nga shpërblimet në vlerën 41.160 lekë.
 - Vërtetim nr. *** prot., datë 11.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Luan Mema, gjatë periudhës 30.11.1997 - 30.11.1998, në shumën totale 234.532 lekë.
 - Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Luan Mema, gjatë periudhës 01.11.1998 - 22.05.2000, në shumën totale 319.700 lekë.
 - Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Luan Mema, gjatë periudhës maj - tetor 2000, në shumën totale 101.470 lekë.
 - Vërtetim datë 12.04.2018, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi Luan Mema, gjatë periudhës 01.08.2001 - 31.03.2005, në shumën totale 1.279.340 lekë.
 - Lëvizjet e llogarisë bankare në emër të Luan Mema në RFZ Bank, periudha 01.04.2005 - 04.04.2018.
 - Lëvizjet e llogarisë bankare në emër të Luan Mema, në ISP Bank, periudha 01.01.2008 - 17.12.2013.
 - Lëvizjet e llogarisë bankare në emër të Luan Mema në BKT, periudha 01.04.2008 - 06.04.2018.
 - Vërtetim datë 02.08.2023, mbi produktet bankare të klientit Luan Mema pranë Raiffeisen Bank, periudha 2005 - 2022.
 - Vërtetim datë 09.02.2023 nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, për Luan Mema, i angazhuar si personel akademik me kohë të pjesshme. Për periudhën akademike 2021 - 2023 ka përfituar të ardhura në shumën totale neto 52.746 lekë.
 - Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.04.2018, nga DRT Elbasan drejtuar shtetasit Luan Mema, lidhur me aktivitetin e zhvilluar prej tij në Degën Tatimore Gramsh, konfirmohet kodi fiskal i aktivitetit tregtar "Alb Medicin" shpk, me nr. ***, regjistruar më datë 20.06.1995, me vendimin e gjykatës nr. ***. Adresa e veprimtarisë: Lagja "****", Gramsh. Bashkëlidhur ndodhet licenca e aktivitetit tregtar, lëshuar nga Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, Komisioni i Dhënies së Licencave Profesionale.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Luan Mema dhe pagat e kreditura gjatë periudhës prill 2005 - gusht 2009 dhe nëntor 2013 - mars 2023, në vlerën totale rreth 11.625.000 lekë.
- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetasit Luan Mema, ku evidentohen pagesa qiraje nga: Perry-Al, periudha 14.05.2008 - 02.07.2008, në shumën 75.000 lekë, Qendra Formimit Profesional Rehabilimit Durrës në gusht

2008, transferon shumën 300.000 lekë, me përshkrim “likuidim i pjesshëm qira godine”, 2008 - 2009, si dhe në vijim për periudhën prill 2009 - janar 2012 janë depozituar cash për QFPR Durrës, pagesa qiraje në vlerën totale prej rreth 1.169.000 lekë.

✚ **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Luan Mema dhe pagat e kreditura nga Bashkia Durrës, gjatë periudhës 03.11.2008 - 07.11.2013, në vlerën totale rreth 2.435.000 lekë.

✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: mars 2012 - mars 2023, pranë Bashkisë Durrës, Drejtorisë së Policisë Qarkut, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorive Vendore të Policisë Durrës dhe Berat.

Gjithashtu, konfirmohen të ardhura të realizuara nga Luan Mema pranë Universitetit “A. Moisiu”, gjatë periudhës shtator - tetor 2022.

Me shkresën *** Prot., datë 09.08.2023, për periudhën deri në vitin 1990, konfirmohen ditë punësimi të shtetasit Luan Mema në Koop. Bujqësore Mashan-Gramsh, gjithsej 300 ditë.

✚ **DRT Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema: Rezulton i regjistruar në DRT Elbasan, në subjektin “Komisariati i Policisë Gramsh”, me datë regjistrimi 07.11.1997 dhe pasiv, po nga data 07.11.1997.

Rezulton i regjistruar në DRT Tiranë, si Person Fizik, me NIPT ***, me datë krijimi 13.01.2006 dhe kalim në status pasiv, prej datës 16.06.2011.

Rezulton i regjistruar në DRT Durrës, si Person Fizik, me NIPT ***, me datë krijimi 24.10.2005 dhe kalim në status pasiv, prej datës 25.07.2012.

Referuar shkresës, të dhënat e mësipërme për shtetasin Luan Mema, nuk janë të plota, mungon ID, datëlindja dhe si e tillë, nuk mund të përcaktojnë që është i njëjti person me atë për të cilin kërkohet informacion.

✚ **DRT Durres**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se nga verifikimi në sistemin C@ts për kontratën e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.07.2008, rezulton se shtetasi Fadil Kadrimi, në cilësinë e administratorit të subjektit QFPR me NIPT *** dhe shtetasi Luan Mema, nuk kanë asnjë pagesë për periudhën 2008 - 2013.

Referuar shkresës së DRT Elbasan e cila konfirmon se shtetasi Luan Mema është i regjistruar si Person Fizik me dy NIPT-e, Trupa e Vlerësimit verifikoi në QKB mbi subjektet me NIPT *** dhe ***, nga ku rezultoi se ishin shtetas të ndryshëm nga subjekti Luan Zylal Mema.

- Në kthim përgjigjen nr. ***, datë 20.06.2024, pranë Trupës së Vlerësimit, subjekti ka paraqitur shpjegime me shkrim, lidhur me pagesën e tatimit në burim, të objektit të dhënë me qira, me qiramarrës Perry Al Shpk, si dhe Qendrës së Formimit Profesional dhe Rehabilitimit Durrës. Për qiramarrësin Perry Al Shpk, sqaron se referuar Ligjit nr. 8438, datë, 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, pagesa e tatimit në burim kryhet nga subjekti i regjistruar i cili është qiramarrësi. Në rastin konkret referuar kontratës së qirasë çmimi i qirasë ka qenë 27.800 lekë prej të cilës, qiramarrësi ka mbajtur shumën e pagesës së tatimit në burim, kjo vërtetohet edhe nga pagesat bankare që ka bërë Perry Al Shpk. Për qiramarrësin Qendra e Formimit

Profesional dhe Rehabilitimit Durrës, subjekti i është referuar përsëri Ligjit nr. 8438, datë, 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ku pagesa e tatimit në burim kryhet nga subjekti i regjistruar. Subjekti ka sqaruar se referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas ekspertit financiar i thirrur nga gjykata, Qendra e Formimit Profesional dhe Rehabilitimit Durrës, ka paguar vetëm shumën 36000 lekë. Qendra e Formimit Profesional dhe Rehabilitimeve Durrës ia ka mbajtur nga qiraja vlerën e tatimit në burim dhe kjo vërtetohet edhe nga pagesat bankare që ka bërë qiramarrësi, Qendra e Formimit Profesional dhe Rehabilitimit në BKT, pasi nuk i ka dhënë të plotë pagesën e qirasë, pra depozitimi nuk ka qënë i rregullt për vitin 2008-2013 dhe për këtë arsye e ka dërguar në Gjykatë. (Çështja për pagesën nga qiraja akoma nuk është ekzekutuar nga Zyra Përmbartimore). Bashkëlidhur si më poshtë:

- Kthim përgjigje nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, ku korfimon pagesën e tatimit në burim nga tatimpaguesi Perry Al Shpk, si dhe bën me dije se nga tatimpaguesi Qendra e Formimit Profesional Durrës, nuk ka pagesë të tatimit në burim.
- Vendimin nr. ***, datë 22.01.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- **Në kthim përgjigjen nr. ***, datë 20.06.2024**, pranë Trupës së Vlerësimit, subjekti sqaroi se lidhur me të ardhurat si personel në Universitetin Aleksandër Moisiu, ka vepruar sipas nenit 91, të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, ku ka marrë miratimin me shkrim nga Drejtuesi i Strukturës. Bashkëlidhur si më poshtë:
 - Shkresën nr. ***, prot, datë 21.09.2021, të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, “Leje për t’u aktivizuar në mësimdhënie pranë UAMD”.
 - Shkresën nr. ***, prot, datë 31.08.2022, të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, “Leje për t’u aktivizuar në mësimdhënie pranë UAMD”.
- ✓ **Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe shpërblimet, për periudhën nëntor 1997 – mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 16.408.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti ka deklaruar të ardhura nga funksionet e kryera pranë Nd/jes Pjore, Komitetit Ekzekutiv, Policisë Financiare dhe Nd/jes Grumbullim Përpunimit Gramsh, në shumën rreth 220.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhurat nga qiraja, për periudhën maj 2008 - janar 2012, konfirmohen nga sistemi bankar, në vlerën totale rreth 1.544.000 lekë.**

DETYRIMET FINANCIARE

35. Kredi në Raiffeisen Bank, disbursuar në 01.09.2020, në shumën 1.950.000 lekë, këst mujor 32.428 lekë, afat shlyerje 7 vjet. Detyrimi i pashlyer i kredisë në datë 08.02.2023 në shumën 1.429.879 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë kredie bankare, nënshkruar në datë 01.09.2020, ndërmjet kredithënësit Raiffeisen Bank dhe kredimarrësit Luan Mema, të kredisë me vlerë 1.950.000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë, për arsye personale. Afati i shlyerjes 84 muaj.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon kredi në emër të shtetasit Luan Mema dhe detyrimin financiar, në vlerën rreth 1.389.000 lekë. Kredia është disbursuar në datën 01.09.2020, në vlerën 1.950.000 lekë, nga e cila 1.296.000 lekë, kanë shlyer kredinë e marrë në datë 19.04.2019.
- ✓ **Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.**

36. Kartë krediti Raiffeisen bank, datë 16.06.2017. Detyrimi financiar 100.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Marrëveshje mbi përdorimin e kartës së kreditit Mastercard, nënshkruar në datë 09.06.2017 nga Luan Mema, në Raiffeisen Bank. Limiti i aprovuar i kartës është 100.000 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon llogari për tërheqje Master Card, në emër të shtetasit Luan Mema. Balanca 0 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank. Nuk rezultojnë detyrime financiare të pashlyera më datë 06.03.2023.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

- Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.
- 37. Shpenzime për energji elektrike kontratë nr. *** dhe nr. ***. Shuma 100.850 lekë.**
- 38. Shpenzime për ujë, kontratë nr. ***. Shuma 12.939 lekë.**
- 39. Shpenzime për internet kontrata me Abcom. Shuma 24.000 lekë.**
- 40. Shpenzime për telefon Luan Mema, Ardiana Mema, Viola Mema, Arbër Mema. Shuma 40.800 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë për furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike, datë 13.05.2002, nënshkruar ndërmjet Ndërmjarres Energjitike Durrës dhe Luan Mema.
- Librezë energjie elektrike në emër të Luan Mema, kontratë nr. ***. Shuma e paguar për vitin 2022, në vlerën rreth 36.000 lekë.

- Kontratë për furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike, datë 13.12.2001, nënshkruar ndërmjet Ndërmarrjes Energjitike Durrës dhe Luan Mema.
 - Librezë energjie elektrike në emër të Luan Mema, kontratë nr. ***. Shuma e paguar për vitin 2022, në vlerën rreth 64.000 lekë.
 - Librezë UKD në emër të Luan Mema, kontratë nr. ***. Shuma e paguar për vitin 2022, në vlerën rreth 13.000 lekë.
 - Faturë tatimore shitje nga ABCOM shpk., për Luan Mema, tetor 2016. Shuma e faturuar 1.699 lekë.
- ✚ **FSHU**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi me energji elektrike në emër të Luan Zylal Mema. Konfirmohet se me gjeneralitetet Luan Mema, figurojnë të regjistruara 12 kontrata furnizimi me energji elektrike, në instancat Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Në dokumentacion bashkëlidhur, konfirmohen kontratat e deklaruara nga subjekti në Durrës, me nr. *** dhe ***.
- ✚ **Ujësjelles - Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. ***, konfirmojnë dy kontrata në emër të shtetasit Luan Mema.
Kontrata nr. ***, në rrugën “***”, status “aktiv”, për të cilin nuk disponojnë dokumentacion vërtetues, lidhur me faktin nëse ky shtetas është i njëjtë me subjektin për të cilin kërkohet informacion.
Kontrata nr. ***, në rrugën “****”, status “aktiv”. Bashkëlidhur ndodhet karta e identitetit e shtetasit Luan Mema, ditëlindja 28.06.1970.
- ✚ **Shoqëria Rajonale ujësjellës - Kanalizime Durrës**, me shkresën nr. ***, konfirmon dy kontrata në emër të shtetasit Luan Mema, në instancën Durrës dhe një tjetër në instancën Krujë; Kontrata nr. ***, Lagjja ***, Durrës, për të cilën nuk disponohet dokumentacion në lidhje me gjeneralitetet e zotëruesit të kontratës. Kontrata ishte me status pasiv dhe nuk është faturuar asnjëherë.
Kontrata nr. ***, Shkollë Private, me adresë Lagjja ***, Rr. “****” Durrës, për të cilën nuk disponohet dokumentacion në lidhje me gjeneralitetet e zotëruesit të kontratës. Vlera e faturuar për vitin 2022 është 12.650 lekë.
Kontrata nr. ***, Krujë, për të cilën nuk disponohet dokumentacion në lidhje me gjeneralitetet e zotëruesit të kontratës.
- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Vlorë**, me shkresën nr. *** konfirmon një kontratë në emër të shtetasit Luan Mema, nr. ***, në instancën Vlorë. Nuk disponohet dokumentacion në lidhje me gjeneralitetet e zotëruesit të kontratës.
- ✚ **15 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime**, me shkresat nr. *** - *** prot.; *** - *** prot. dhe nr. *** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Vodafone Albania sh.a**, me shkresën nr. ***, datë 03.11.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Luan Mema (Drejtorja e Policisë së Qarkut Durrës), figuron një numër aktiv; nr ***,

datë aktivizimi 08.11.2013. Vlera e shpenzuar gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, është në vlerën totale prej 7.600 lekë.

Shtetases Ardiana Mema i korrespondojnë dy numra telefoni nr ***, aktivizuar prej datës 09.11.2020 dhe nr ***, aktive për periudhën 24.06.2022 - 25.09.2023. Vlera e shpenzuar për vitin 2022, gjithsej 8.000 lekë.

Shtetases Viola Mema, i korrespondojnë dy numra telefoni nr ***, aktivizuar prej datës 09.10.2021 dhe nr ***, aktive për periudhën 25.01.2022 - 28.04.2023. Nuk konfirmohen pagesa të kryera për këto numra.

Shtetasit Arbër Mema i korrespondon një numër telefoni nr ***, aktivizuar prej datës 08.04.2019. Nuk konfirmohen pagesa të kryera për këtë numër.

Gjithashtu, konfirmohet se shtetasit Luan Mema dhe Viola Mema, kanë kontratë të telefonisë fikse dhe/ose internet. Vlera e shpenzuar për këto kontrata është në total 19.500 lekë.

- ✚ **One Albania sh.a**, me shkresën nr. ***, datë 26.09.2023, konfirmon se shtetasi Luan Mema, rezulton i regjistruar me nr ***. Vlera e shpenzuar për vitin 2022, gjithsej 3.400 lekë. Shtetasi Arbër Mema, rezulton i regjistruar me dy numra nr ***; nr *** dhe totali i pagesave për vitin 2022 është 15.358 lekë.

Shtetasja Viola Mema rezulton e regjistruar me një numër nr *** dhe totali i pagesave për vitin 2022 është 3.200 lekë.

- ✚ **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

- ✚ **Abissnet sh.a**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

- ✚ **Digicom sh.a**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se nuk ka lidhur asnjëherë kontratë me Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë, pasi nuk disponon banesë atje. Gjithashtu deklaroi se nuk ka lidhur kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Krujë, Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë, si dhe nuk ka lidhje me kontratën nr. ***, Lagjja ***, Durrës në emër të Luan Mema, pasi ai banon në adresën, Lagjja ***, Rruga “****”, banesa nr. *** dhe nuk ka banesë të dytë në pronësi.

Në lidhje me Kontratën nr. ***, Shkollë Private, në adresën, Lagjja ***, Rruga “****”, Durrës, sqaroi se kjo është kontrata e banesës së tij, e cila ka ngelur në emër të Shkollës Private prej vitit 2008, kur ka nënshkruar kontratën e qirasë me Qendrën e Formimit Profesional dhe Rehabilitimeve “Ne për Durrësin”, dhe nuk e ka ndryshuar.

Lidhur me konfirmimet nga FSHU, subjekti deklaroi se nuk disponon asnjë kontratë furnizimi të energjisë elektrike me OSHE-në, Tiranë dhe Elbasan. Nga verifikimet e kryera prej tij, pranë OSHEE, rezultoi se në sistem figuron një kontratë me emër të Luan Mema, në qytetin e Gramshit, me kontratë Nr. ***. Kjo kontratë ka mbetur që nga momenti i largimit nga Qyteti i Gramshit, kur ka ardhur me banim në Durrës, në vitin 2001. Ka bërë kërkesë pranë zyrave përkatëse në Gramsh, për çregjistrimin e kontratës nga faturimi i energjisë elektrike, por kjo

kontratë është ende aktive. Sqaroi se kontrata nuk është çregjistruar nga emri Luan Mema, pasi godina nuk ka pronësi, sipas vërtetimit të leshuar nga Bashkia Gramsh datë 25.01.2024.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 23.01.2024, nga UKT Durrës, për Luan Mema, i cili disponon kontratën me numër ***, datë hapje 28.07.2006, rruga “****”, Lagjja ***, Durrës. Nuk rezulton të jetë debitor ndaj shqërisë.
- Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.01.2024, nga FSHU, drejtuar shtetasit Luan Mema, për kontratat nr. *** dhe nr. ***, ku ky shtetas është titullar, janë kontrata aktive të hapura me datë 24.08.2001 dhe datë 29.05.2002.
- Vërtetim datë 23.01.2024, nga Bashkia Durrës, për shtetasin Luan Mema, i cili është banor i Lagjes nr. ***, Rr. “****”, banesa nr. ***.

✓ **Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 170.000 lekë.**

- Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur, jashtë territorit shqiptar gjatë tre viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022

41. Shpenzime për udhëtim në Prizren 20.03.2021 - 21.03.2021. Shuma 75 euro.

42. Shpenzime për udhëtim në Shën Naum 01.01.2021. Shuma 40 euro.

43. Shpenzime për udhëtim në Prizren 27.04.2019 - 28.04.2019. Shuma 30 euro.

44. Shpenzime për udhëtim Ardiana Mema në Prizren 20.03.2021 - 21.03.2021. Shuma 75 euro.

45. Shpenzime për udhëtim Ardiana Mema në Shën Naum 01.01.2021. Shuma 40 euro.

46. Shpenzime për udhëtim Ardiana Mema në Prizren 27.04.2019 - 28.04.2019. Shuma 30 euro.

47. Shpenzime për udhëtim Viola Mema në Strugë 07.02.2023 - 08.02.2023. Shuma 40 euro.

48. Shpenzime për udhëtim Viola Mema në Barcelon 16.11.2022 - 21.11.2022. Shuma 299 euro.

49. Shpenzime për udhëtim Viola Mema në Prizren 14.05.2022. Shuma 50 euro.

50. Shpenzime për udhëtim Viola Mema në Prizren 15.04.2022 - 16.04.2022. Shuma 80 euro.

51. Shpenzime për udhëtim Arbër Mema në Stamboll 19.02.2022 - 23.09.2022. Shuma 180 euro.

52. Shpenzime për udhëtim Arbër Mema në Bari 19.04.2021 - 24.05.2021. Shuma 100 euro.

53. Shpenzime për udhëtim Arbër Mema emigrant në Island 20.03.2021. Shuma 150 euro.

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se djali i tij Arbër Mema ka kryer udhëtim në Stamboll më datë 19.09.2022 deri më 23.9.2022. Data e vendosur në deklaratë është lapsus. Paraqiti lëvizjet e sistemit TIMS për familjarët e tij:

- Luan Mema

Dalje më 21.11.2020 - Hyrje më 21.11.2020

Dalje më 01.01.2021 - Hyrje më 01.01.2021

Dalje më 20.03.2021 - Hyrje më 21.03.2021

- Ardiana Mema

Dalje më 21.11.2020 - Hyrje më 21.11.2020

Dalje më 01.01.2021 - Hyrje më 01.01.2021

Dalje më 20.03.2021 - Hyrje më 21.03.2021

Hyrje 16.08.2021

- Arbër Mema

Dalje më 28.07.2020

Dalje më 20.03.2021 - Hyrje më 21.05.2021

Dalje më 19.05.2021 - Hyrje më 16.08.2021

Dalje më 19.09.2022 - Hyrje më 23.09.2022

- Viola Mema

Dalje më 07.02.2023 - Hyrje më 08.02.2023

Dalje më 16.11.2022 - Hyrje më 21.11.2022

Dalje më 14.05.2022

Dalje më 15.04.2022 - Hyrje më 16.04.2022

Hyrje më 07.01.2022

✓ **Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në total rreth 1.200 euro, konvertuar rreth 137.000 lekë. Subjekti ka dokumentuar hyrje/daljet nga RSH gjatë periudhës 2020 - 2022.**

▪ Për arsimin e fëmijëve, madhore apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit:

54. Shpenzime për arsimin e Arbër Mema. Shuma 1.200 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

➤ Kontrata e regjistrimit të studentit nënshkruar në datë 29.09.2021, ndërmjet Kolegjit Universitar të Biznesit dhe studentit Arbër Mema, për vitin akademik 2021-2022, në vlerën totale prej 1.200 euro.

• **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, në lidhje me shkollimin parauniversitar të fëmijëve, subjekti deklaroi se djali Arbër Mema ka studiuar në Shkollën e Mesme Publike “Leonik Tomeu” Durrës, ndërsa vajza Viola Mema në Shkollën e Mesme pranë Gjimnazit Publik “Naim Frashëri” Durrës.

✓ **Shpenzimet për arsimimin e djalit, gjatë periudhës 2021 – 2022, janë deklaruar 1.200 euro, konvertuar rreth 137.000 lekë.**


DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – ARDIANA MEMA

DEKLARIMI I PASURIVE

55. Automjet BMW X5, targë ***, vit prodhimi 2002, blerë më 14.02.2018. Vlera 1.800 euro. Pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: nga kursimet e të ardhurave familjare. Të ardhura nga puna e djalit Arbër Mema, në shumën 1.189 euro, emigrant në Island, sipas dokumentit datë 13.02.2018.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.02.2018, nënshkruar ndërmjet palës shitëse D.M dhe palës blerëse Ardiana Mema, të automjetit BMW X5, vit prodhimi 2002, targë ***, kundrejt çmimit 1.800 euro. Palët deklarojnë se janë likuiduar totalisht midis tyre.
- Formular tërheqje në AK Invest, datë 13.02.2018, të shumës 1.189 euro, me palë përfutuese Ardiana Mema. Dërgues Arbër Mema, shteti i dërgesës Iceland.

 **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***, datë 14.08.2023, konfirmon se shtetasja Ardiana Mema ka të regjistruar, në pronësi të saj, automjetin me targë ***. Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.02.2018, nënshkruar ndërmjet palës shitëse D.M dhe palës blerëse Ardiana Mema, të automjetit BMW X5, vit prodhimi 2002, targë ***, kundrejt çmimit 1.800 euro. Palët deklarojnë se janë likuiduar totalisht midis tyre.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorezuar dhe pergligjen e DPSHTRR.**

56. Tokë arë me sip. 12.600 m², në pronësi të familjes së H.D, në fshatin Gostin, Bashkia Cërrrik, përfutuar në bazë të ligjit nr. 7501. Anëtar i familjes, sipas certifikates për gjendjen familjare më 01.08.1991. Pjesë takuese 25%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Akti i marrjes së tokës në pronësi, në të cilën i jepet familjes së H.D, sip. toke bujqësore gjithsej 15.950 m², në fshatin Gostinë.
- Certifikatë familjare, lëshuar në bazë të regjistrimit themeltar të vitit 1974, në Fshatin Gostinë, të familjes së shtetasit Hamit Duzha dhe dy anëtarëve Diqe Duzha e Ardiana Duzha, gjendje familjare në datë 01.08.1991.
- Vendim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.12.2021, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, për të ndjerin H.D, duke caktuar si trashëgimtar ligjorë të radhës së parë fëmijët Q.D, B.D, M.Sh, Ardiana Mema, në mënyrë të barabartë me pjesë takuese 1/4 secili.

- Plan rilevimi i pasurisë nr. ***, ZK ***, me sip. 9.590 m2 tokë arë, për ndarjen e saj në pasurinë nr. ***, me sip. 1.370 m2 dhe nr. ***, me sip. 8.220 m2.
- **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.09.2023, konfirmon në emër të shtetases Ardiana Mema, pasurinë nr. ***, e llojit “arë”, me sip. 1.370 m2, ndodhur në fshatin Gostinë, ZK 1820, e përfitur me dëshmi trashëgimie dhe kontratë pjestimi, ndërmjet bashkëtrashëgimtarëve. Bashkëlidhur:
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme e pasurisë Arë, me sip. 1.370 m2, regjistruar me nr. ***, në emër të Ardiana Mema, sipas kontratës së pjestimit nr. ***, datë 24.12.2022, regjistruar më datë 24.02.2023.
 - Kartela e pasurisë së paluajtshme e pasurisë Arë, me sip. 9.500 m2, regjistruar me nr. ***, në emër të H.D (6/15 pjesë), Ardiana Mema (6/15 pjesë), D.D (1/15 pjesë), B.D (1/15 pjesë), M.Sh (1/15 pjesë), përfitur me dëshmi trashëgimie.
 - Dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.11.2018, kërkues B.D, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen D.D, duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë, bashkëshortin H.D dhe fëmijët Q.D, B.D, M.Sh dhe Ardiana Mema, pjesë takuese 1/5 pjesë secili.
 - Kontrate pjestimi pasuri e paluajtshme (tokë bujqësore-arë), nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2022, ndërmjet palëve Q.D, B.D, M.Sh dhe Ardiana Mema, të pasurisë “Arë”, në bashkëpronësi të palëve dhe konkretisht të pasurive me nr. ***, me sip. 9.590 m2 dhe nr. *** me sip. 1.019 m2, ndodhur në Gostinë, Elbasan. Sipas kontratës, Ardiana Mema merr në pronësi nga pasuria nr. ***, sipërfaqen prej 1.370 m2, duke deklaruar heqjen dorë nga pasuritë e tjera objekt i kësaj kontrate.
- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se bashkëshortja ka në pronësi 1.370 m2, pasi ka hequr dorë nga pasuritë që do përfitonte nga trashëgimia e prindërve. Sipas AMTP, H.D ka marrë tokë arë gjithsej 15.950 m2. Arsyeja e deklarimit të sip. 12.600 m2, është se ka zbritur sip. e tokës së shitur prej 3.016m2, me kontratë nr. ***, datë 18.01.2022.
- **Në proces verbalin e datës 11.03.2024, të mbajtur në ILDKPKI**, subjekti sqaron se në këtë pasuri nuk janë kryer investime.

Bazuar në deklarinimin e bashkëshortes së subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Deklarohet 12.600 m2 tokë arë, përfitur nga ligji 7501. Kjo sip. është deklaruar referuar sip. me AMTP, prej 15.900 m2, duke zbritur sip. e tokës së shitur prej 3.016 m2. Pas çeljes së trashëgimisë ligjore, pjestimit vullnetar dhe pas shitjes së një pjese të saj, bashkëshortja e subjektit disponon një sip. prej 1.370 m2. Kjo sipërfaqe konfirmohet nga ASHK Elbasan, si dhe nga vetë subjekti në sqarimet e paraqitura.

- ✓ **ASHK konfirmon në emër të bashkëshortes pasurinë toke arë, me sip. 1.370 m2, Gostinë, Cërrik, përfituar nga ligji 7501 dhe trashëgimia. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me sip. e deklaruar.**

57. Llogari në Raiffeisen Bank, me gjendje në datën 01.03.2023, në vlerën 49.897 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga neto.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Lëvizjet e llogarisë në emër të Ardiana Mema, pranë Raiffeisen Bank, gjatë periudhës 22.07.2015 - 07.02.2023. Gjendje në llogari në datën 07.02.2023, në vlerën 66.022 lekë.

✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetases Ardiana Mema dhe gjendjen datë 06.03.2023, në vlerën 75.367 lekë.

- ✓ **Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.**

58. Llogari në BKT me gjendje në vlerën 0 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga neto.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Lëvizjet e llogarisë në emër të Ardiana Mema pranë BKT, gjatë periudhës 05.06.2008 - 10.04.2018. Rezulton se në datë 10.04.2018, llogaria është mbyllur. Gjendje në llogari në datë 06.03.2023, në vlerën 0 lekë.

✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetases Ardiana Mema dhe gjendjen datë 06.03.2023, në vlerën 0 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

59. Të ardhura nga punësimi në Qendrën Ekonomike të Arsimit Gramsh, për periudhën 06.10.1992 - 10.01.1993. Shuma e të ardhurave 2.400 lekë.

60. Të ardhura nga punësimi në Ndërmarrjen Eterovajore Gramsh, për periudhën 10.01.1993 - 10.12.1994. Shuma e të ardhurave 7.700 lekë.

61. Të ardhura nga papunësia (asistencë), Zyra e Punësimit Gramsh, për periudhën 11.12.1994 - 11.12.1995. Shuma e të ardhurave 8.500 lekë.

62. Të ardhura nga paga neto (shtesë page bashkëshorti si i transferuar nga data 01.12.1998 - 22.05.2000). Shuma e të ardhurave 98.232 lekë.

63. Të ardhura nga paga neto (shtesë page bashkëshorti si i transferuar nga data 23.05.2000 - 24.10.2000). Shuma e të ardhurave 33.860 lekë.

64. Të ardhura nga paga neto (shtesë page bashkëshorti si i transferuar nga data 01.08.2001 - 15.6.2005). Shuma e të ardhurave 381.700 lekë.
65. Të ardhura nga paga neto (shtesë page bashkëshorti si i transferuar nga data 16.06.2005 - 20.2.2006). Shuma e të ardhurave 77.728 lekë.
66. Të ardhura neto në Ndërmarrjen Komunale Plazh Bashkia Durrës, nga data 02.04.2008 - 31.8.2012 (13). Shuma e të ardhurave 1.085.238 lekë.
67. Të ardhura nga paga neto për punën në shtëpinë e pushimit të Ministrisë së Brendshme, nga data 13.06.2014 - 11.09.2014. Shuma e të ardhurave 74.028 lekë.
68. Të ardhura nga paga neto pranë subjektit Person Fizik Eduart Hysa, periudha 01.10.2014 - 01.12.2014. Shuma e të ardhurave 39.072 lekë.
69. Të ardhura nga paga neto (shtesë page bashkëshorti si i transferuar nga data 01.12.2014 - shtator 2021). Shuma e të ardhurave 2.227.057 lekë.
70. Të ardhura nga paga neto pranë Hekurudhës Durrës, periudha nëntor 2021 - shtator 2022. Shuma e të ardhurave 267.410 lekë.
71. Të ardhura nga paga neto, pranë Ujësjetës Kanalizime Durrës, periudha shtator 2022 e në vazhdim. Shuma e të ardhurave 181.493 lekë.
72. Të ardhura nga shitja e pasurisë “arë” me sip. 3.016 m², fshati Gostinë Elbasan, sipas kontratës nr. ***, datë 18.01.2022, vlerë 300.000 lekë. Pjesë takuese 25%. Shuma e të ardhurave 75.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.04.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, për të ardhurat e përfituara nga pagesa e Ardiana Mema, gjatë periudhës 16.06.2005 - 19.2.2006, në vlerën 77.728 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, për të ardhurat e realizuara nga shtetasja Ardiana Mema, gjatë periudhës 01.11.1998 - 22.05.2000, në shumën totale 98.232 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, për të ardhurat e realizuara nga shtetasja Ardiana Mema, gjatë periudhës qershor - tetor 2000, në shumën totale 33.860 lekë.
- Vërtetim datë 12.04.2018, nga Departmenti për Kufirin dhe Migracionin për të ardhurat e përfituara nga pagesa e Ardiana Mema, gjatë periudhës 01.08.2001 - 31.03.2005, në vlerën 381.700 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto nga ISSH, për të ardhurat e realizuara nga Ardiana Mema, pranë Nd/jes Komunale Plazh, gjatë periudhës 02.04.2008 - 31.12.2012 dhe 15.05.2013 - 31.08.2013, në shumën totale neto 1.085.258 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 25.05.2015, nga DRT Durrës për Ardiana Mema, e cila ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë “Ndërmarrjes Komunale Plazh”, gjatë periudhës maj - gusht 2013.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto nga ISSH, për të ardhurat e realizuara nga Ardiana Mema, pranë Shtëpisë së Pushimit M. P. Brendshme, gjatë periudhës qershor - shtator 2014, në shumën totale neto 74.028 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 25.05.2015, nga DRT Durrës për Ardiana Mema, e cila ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë “Shtëpisë së Pushimit, M. Brendshme”, gjatë periudhës qershor - shtator 2014.

- Vërtetim nr. *** prot., datë 30.01.2015, nga DRT Durrës, për Ardiana Mema, e cila ka përfituar të ardhura bruto nga punësimi pranë “Person Fizik/Juridik E.H”, gjatë periudhës tetor - nëntor 2014, në shumën 44.000 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasës Ardiana Mema dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 02.09.2015 - mars 2023, në vlerën totale rreth 2.725.000 lekë.
- ✚ **BKT** me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasës Ardiana Mema dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 05.06.2008 - 11.01.2013, nga Ndërmarrja Komunale Plazh Durrës dhe për periudhën 09.07.2014 - 01.10.2014, nga Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Brendshme.
- ✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. ***, datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasja Ardiana Mema ka pasur llogari, në të cilën janë kredituar pagat nga Nd/ja Komunale Durrës, gjatë periudhës 06.06.2013 - 06.09.2013.
- ✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 04.09.2023 konfirmon se shtetasja Ardiana Mema ka pasur në bashkëpronësi pasurinë nr. 17/13/1, e llojit “Arë”, me sip. 3.016 m2; ndodhur në fshatin Gostinë, ZK ***, e përfituar me dëshmi trashëgimie dhe kontratë pjestimi ndërmjet bashkë-trashëgimtarëve. Bashkëlidhur:
 - Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.01.2022 (tokë arë), nënshkruar ndërmjet palës shitëse B.D, Q.D, Ardiana Mema, M.Sh dhe palës blerëse I.Xh, të pasurisë lloji “arë” me sip. totale 3.016 m2, regjistruar me nr. ***, ZK ***. Çmimi i shitjes 300.000 lekë, do të paguhet në llogarinë e noterit pranë Tirana Bank (referuar pjesës takuese, vlera e përfituar 75.000 lekë).
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasja Ardiana Mema ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: janar 2012 - mars 2013 pranë Komunale Plazh, Shtëpia e pushimit M. Brendshme, E.H, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Hekurudha Shqiptare, Ujësjellës Kanalizime Durrës. Të ardhurat neto pranë E.H PF, për periudhën tetor - nëntor 2014, rezultojnë në vlerën 38.324 lekë.
Me shkresën *** Prot., datë 09.08.2023, për periudhën deri në vitin 1990 konfirmohen ditë punësimi të shtetasës Ardiana Mema në Koop. Bujqësore Gostinë, gjithsej 947 ditë.
- ✓ **Të ardhurat e bashkëshortes nga pagat, etj., për periudhën nëntor 1998 - mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 4.514.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme tokë arë, pjesa takuese në vlerën 75.000 lekë.**

DEKLARIMI I DJALIT – ARBËR MEMA

DEKLARIMI I PASURIVE

73. Të ardhura si emigrant në Island, për periudhën gusht 2017 - mars 2018. Shuma 1.189 euro.
74. Të ardhura si kursant për patrullë të përgjithshme në Kolegjin e Policisë në Akademinë e Sigurisë, për periudhën 16.10.2022 e në vazhdim. Shuma 40.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Formular dërgesë datë 13.02.2018, nga AK Invest, shuma 1.189 euro, me dërgues Arbër Mema, shteti i dërgeses Iceland; palë përfituese Ardiana Mema.
- Vërtetim *** prot, datë 10.02.2023, nga Akademia e Sigurisë për Arbër Mema, i cili është kursant i kursit XVII-të, për patrullë të përgjithshme në Kolegjin e Policisë, në Akademinë e Sigurisë. Paguhet nga data 16.10.2022, me vlerën 8.000 lekë/muaj.
- ✚ **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon pagat e kredituara gjatë periudhës 07.12.2022 - 02.03.2023, në vlerën totale prej 36.000 lekë.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2023, konfirmon se në atë 24.05.2017 është kredituar shuma 9.800 lekë nga subjekti Besnik Laze-PF.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasi Arbër Mema ka realizuar të ardhura në muajin prill 2017, pranë subjektit Besnik Laze.
- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se djali ka qëndruar emigrant me kohë të pjesshme në Island, pasi nuk i'u pranua konkurrimi për të vazhduar studimet e larta atje. Nga viti 2017 - 2021 ka punuar e krijonte të ardhura në punë të ndryshme në sektorin e ndërtimit. Gjatë qëndrimit në Island, nuk ka pasur shumë shpenzime për vendbanimin, pasi ka banuar në banesën e shtetasit E.D (djali i dajës së Arbrit) dhe bashkëjetueses së tij, D.Ch.
R.D ishte me dokumenta të regullta si rezident në Island.

Subjekti paraqiti:

- Leje qëndrimi e shtetasit E.D, në Reykjavik, datë 28.06.2019.
- Marrëveshje qiraje (në gjuhën islandeze), nënshkruar në datë 01.11.2018, nga shtetasja D.Ch

Me postën elektronike të datës 26.1.2024, pranë ILDKPKI subjekti paraqiti:

- Deklaratë datë 26.01.2024, sipas së cilës, shtetasi E.D, deklaroi se kushëriri i tij Arbër Mema, në periudhën 3 muajore të punësimit të tij në Reykjavik, Island, ka banuar në shtëpinë e tij, të cilën e kishte marrë me qira dhe banonte me shtetasen D.Ch.

- Deklaratë datë 25.01.2024, e shtetasit T.A, nr. ***, i cili deklaron se Arbër Mema ka punuar me kohë të pjesshme në kompaninë e tij HIH Malin Ltd, në Reykjavik Island, gjatë viteve 2017 - 2021, për periudha 90 ditore.
- ✓ **Të ardhurat e djalit nga pagat për periudhën dhjetor 2022 - mars 2023, rezultojnë rreth 36.000 lekë.**
- ✓ **Të ardhurat e djalit nga emigracioni për periudhën gusht 2017 - mars 2018, janë 1.189 euro.**

DEKLARIMI I VAJZËS – VIOLA MEMA

DEKLARIMI I PASURIVE

- 75. Të ardhura nga paga neto pranë subjektit ITSGA sha, periudha prill 2014 - gusht 2014. Shuma e të ardhurave 73.400 lekë.
- 76. Të ardhura nga paga neto pranë subjektit B.L, periudha shkurt 2017 - maj 2017. Shuma e të ardhurave 61.365 lekë.
- 77. Të ardhura nga paga neto pranë subjektit Star Outlet, periudha shkurt mars 2018 – maj 2018. Shuma e të ardhurave 62.500 lekë.
- 78. Të ardhura nga paga neto pranë subjektit Atlas Mills, periudha korrik 2020 - janar 2021. Shuma e të ardhurave 317.180 lekë.
- 79. Certifikatë regjistrimi për aktivitet privat me NIPT ***. Nuk ka gjeneruar të ardhura.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm Viola Mema, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit datë 31.01.2022, me NIPT ***.
- Formular i deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, periudha tatimore 2022, Viola Mema, NIPT ***.
- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasës Viola Mema dhe pagat e kreditura gjatë periudhës 10.04.2018 - 01.06.2018, nga subjekti Star Outlet, në vlerën totale rreth 59.000 lekë.
- ✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema ka pasur llogari page në të cilën janë kredituar pagat nga subjekti Atlas Mills shpk., gjatë periudhës 30.07.2020 - 04.02.2021, në vlerën totale rreth 261.000 lekë.
- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2023 konfirmon se shtetasja Viola Mema ka pasur llogari page në të cilën janë kredituar pagat nga subjekti B.L PF gjatë periudhës 13.03.2017 - 24.05.2017, në vlerën totale rreth 67.000 lekë.

- ✚ **DRT Durrës**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.08.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema, figuron e regjistruar pranë kësaj drejtorie, prej datës 31.01.2022, me NIPT ***. Objekt aktiviteti “tregti me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara”. Statusi “kërkesë për rregjistrim” më datë 02.05.2023. Xhiro e deklaruar për vitin 2022 është në shumën 62.505 lekë dhe humbje në vlerën - 484.938 lekë (shpenzime 547.443 lekë). Detyrimet në datën 03.08.2023 janë në shumën 200.130 lekë.

- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema ka realizuar të ardhura gjatë periudhës: prill 2014 - janar 2021, pranë subjekteve ITSGA Sha, Besnik Laze, Star Outlet, Atlas Mills. Për periudhën janar 2022 - mars 2022, figuron e vetëpunësuar. Të ardhurat neto pranë ITSGA Sh.a, konfirmohen në vlerën neto prej 72.009 lekë.

- ✓ **Të ardhurat e vajzës nga pagat, për periudhën 2017 - 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 460.000 lekë.**

- ✚ **OKB**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema, figuron e pajisur me NIPT ***, status “Aktiv”. Bashkëlidhur ekstrakti historik i regjistrimit tregtar të subjektit Viola Mema, datë regjistrimi 31.01.2022, fushë veprimtarie “tregtia me pakicë e veshjeve dhe këpucëve të ndryshme”, vendi i ushtrimit të aktivitetit Durrës.

- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot., datë 02.08.2023, konfirmon se shetasja Viola Mema figuron e regjistruar në DRT Durrës, me NIPT ***.

- ✚ **NOA**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.08.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema, ka përfituar në datën 04.02.2021, kredinë me vlerë 638.500 lekë, rrefinancuar më datë 29.03.2022, për shumën 994.209 lekë, kredi e cila figuron me detyrim aktiv. Bashkëlidhur: Nxjerrja e llogaris ku figuron disbursimi i fondeve në datë 04.02.2021, në vlerën 638.500 lekë dhe në datë 30.03.2022, në vlerën 500.000 lekë. Kontratat e kredisë, nënshkruar nga huamarrësit Viola Mema dhe E.Z, në datë 04.02.2021, në vlerën 638.500 lekë dhe në datë 29.03.2022, në vlerën 529.500 lekë.

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se aktiviteti tregtar i vajzës Viola Mema PF, me NIPT ***, ka pasur si burim financiar për investimin fillestar, kredinë që ka marrë nga Instituti Financiar NOA, në vitin 2021 dhe në datë 29.03.2022. Kredia është përdorur pjesërisht për blerjen e një automjeti Audi A4 dhe pjesën e mbetur e ka investuar më vonë në këtë aktivitet tregtar. Nuk ka rigjeneruar të ardhura, pasi ka falimentuar dhe ka bërë mbylljen e aktivitetit tregtar. Shuma e mbetur nga detyrimi financiar i kredisë në emër të Viola Mema, më datë 06.03.2023 është në shumën 825.175 lekë. Kredia është likuiduar fillimisht nga vajza me kursimet e saj, pasi në periudha të ndryshme ka punuar si konsulente. Më pas, pagesat e kredisë të Viola Mema, i paguan subjekti së bashku me familjen. Lidhur me mosdeklarimin e kredive të marra nga Viola Mema, sqaron se në periudhën para deklarimit, vajza ka pësuar një aksident dhe si pasojë ka pasur një rëndesë psikologjike dhe

humbje të përkohshme të kujtesës (ka pësuar dëmtime të çrregullimit mendor dhe ka kaluar në trauma psikologjike).

Subjekti paraqiti:

- Mandat pagesa bankare me përshkrimin “pagesë kësti për Viola Mema”, nga Ardiana Mema, periudha prill 2023 - janar 2024.
- Epikrizë përcjellëse mjekësore datë 05.01.2023, lëshuar nga Shërbimi i Urgjencës së Traumës Tiranë për Viola Mema.
- Rekomandim mjekësor për Viola Mema, datë 01.03.2023.
- **Me postën elektronike të datës 18.02.2024, pranë ILDKPKI**, subjekti sqaron se vlera fillestare e investimit në aktivitet ka qënë 150.000 lekë, me burim nga kredia e mbetur pas blerjes së automjetit Audi A4 dhe pjesa tjetër nga rifinancimi i kredisë së datës 29.03.2022, në vlerën 529.000 lekë. Aktiviteti është i mbyllur. Marrëdhënia e vazhës me kredimarrësin tjetër, për kredinë tek NOA, është miqësore.

Subjekti paraqiti:

- Kontratë qiraje noteriale, datë 17.01.2022, me palë qiradhënëse S.M dhe palë qiramarrëse Viola Mema, të një ambienti “lokal” me sip. 52 m2, ndodhur në Lagjen ***, Rr. ***, Durrës, vërtetuar sipas kontratës së sipërmarrjes, me nr. ***, të datës 06.05.2003. Këtë pasuri shtetasi S.M i'a jep shtetasës Viola Mema, për t'a përdorur për aktivitet tregtar. Vlera e qirasë mujore do të jetë 300 euro. Afati i qirasë 3 vite, nga data 20.01.2022 deri më datë 20.01.2025.
- Formular i deklaramentit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, viti 2022, për subjektin Viola Mema, NIPT ***; të ardhurat 62.505 lekë; shpenzimet 547.443 lekë; humbje 484.938 lekë.
- Formular i deklaramentit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, viti 2023, për subjektin Viola Mema, NIPT ***; të ardhurat 0 lekë; shpenzimet 34.961 lekë; humbje 34.961 lekë.

Në kthim përgjigjen nr. *, datë 20.06.2024**, pranë Trupës së Vlerësimit, subjekti sqaroi se vajza e tij Viola Mema, ka jetuar në periudhën 2016 deri në fund të vitit 2022, së bashku me shtetasen R.Sh, në adresën rr. ***, pranë Kompleksit ***, kati ***, ***, Tiranë. Në lidhje me qiranë e banesës nuk ka dijeni për vlerën e qirasë pasi ato shpenzime i mbulonin prindërit e Znj. R.Sh. Bashkëlidhur si më poshtë:

- Deklaratë nga shtetasja R.Sh, e cila konfirmon faktin se Viola Mema, ka jetuar në apartamentin në të cilin ajo banon me familjen e saj.

Bazuar në deklaramentimin e vazhës së subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se;

Në vitin 2022 vajza e subjektit ka çelur një aktivitet tregtar në fushën e “tregtisë me pakicë e veshjeve dhe këpucëve të ndryshme”, aktiviteti konfirmohet nga QKB dhe organet tatimore dhe rezultojnë me humbje. Si burim financiar për investimin fillestar, subjekti deklaroi se kanë shërbyer

kreditë tek NOA, datë 04.02.2021 me vlerë 638.500 lekë dhe më datë 30.03.2022 me vlerë 500.000 lekë. Kreditë janë shlyer fillimisht nga vetë vajza dhe duke filluar nga prill 2023 shlyen nga Ardiana Mema. NOA konfirmon kreditë e marra në emër të vajzës dhe shtetasit E.Z, me të cilin kanë marrëdhënie miqësore. Kreditë dhe detyrimi i mbetur në datën 06.03.2023, në vlerën 825.175 lekë, nuk janë deklaruar nga vajza me shpjegimin se ka pasur probleme shëndetësore. Subjekti ka dokumentuar me anë të epikrizës dhe raporteve mjekësore, problemet shëndetësore të vajzës.

❖ *Rezulton mosdeklarim nga ana e vajzës i kredisë tek NOA, në shumën e ristrukturuar 994.209 lekë, datë 29.03.2022 dhe detyrim i mbetur në shumën 825.175 lekë. Subjekti ka dhënë shpjegime se mosdeklarimi ka ndodhur për shkak të problemeve shëndetësore të vajzës, të cilat i ka dokumentuar me anë të dokumentacionit mjekësor përkatës.*

HETIMI ADMINISTRATIV

✚ Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Union Bank, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, RFZ Invest, Credins Invest, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klientë të tyre, çka përputhet me deklarimin.

✚ Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Kamëz Vorë, Tiranë Jug, Tiranë Veri, Rurale 1, Rurale 2, Zonave të Stimuluara, Berat, Lushnje, Mallakastër, Kuçovë, Malësi e Madhe, Gramsh, Kavajë, Kukës, Elbasan, Kolonjë, Has, Skrapar, Durrës, Bulqizë, Pukë, Tropojë, Mirditë, Përmet, Tepelenë, Sarandë, Vlorë, Shkodër, Gjirokastër, Pogradec, Devoll, Fier, Krujë, Librazhd, Mat, Kurbin, Lezhë, Peqin, Korçë, Dibër, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon kredi konsumatore në emër të shtetasit Luan Mema dhe konkretisht;

- Datë 26.02.2008, në vlerën 676.044 lekë, nga e cila shlyer kredia e mëparshme në vlerën 143.109 lekë. Shlyer totalisht në vlerën 465.350 lekë, në datë 02.08.2011.
- Datë 14.08.2014, në vlerën 500.000 lekë, shlyer totalisht në vlerën 454.631 lekë, me datë 14.10.2015, me anë të kredisë së marrë po në këtë datë, me vlerë 1.020.000 lekë.
- Datë 14.10.2015, në vlerën 1.020.000 lekë, nga e cila 463.804 lekë ka shlyer kredinë e mëparshme. Kredia është shlyer totalisht në vlerën 900.436 lekë, më datë 17.11.2016, me anë të kredisë së marrë në datë 17.11.2016, në vlerën 1.100.000 lekë.
- Datë 17.11.2016, në vlerën 1.100.000 lekë, shlyer me kredinë e datës 19.04.2019, me vlerë 1.500.000 lekë.
- Datë 13.06.2017, në vlerën 200.000 lekë, shlyer me kredinë e datës 19.04.2019, me vlerë 1.500.000 lekë.
- Datë 21.06.2018, në vlerën 360.000 lekë, shlyer me kredinë e datës 19.04.2019, me vlerë 1.500.000 lekë.

- ✚ **Fondi Besa**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.08.2023 konfirmon se shtetasi Luan Mema, ka përfituar kredi në datën 17.03.2011, në vlerën 300.000 lekë, mbyllur më datë 31.08.2012.
- ✚ **BKT**, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023 konfirmon në emër të shtetasit Luan Mema, disbursim kredie datë 17.03.2011, në vlerën 249.713 lekë nga Fondi Besa.
- **Me process verbalin e datës 11.03.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se kreditë konsumatore janë marrë kryesisht për shpenzime të përgjithshme familjare, si dhe rregullime të ndryshme të dhomave të brendshme të objektit të banimit. Kreditë në vijim, kanë shlyer pjesërisht detyrimet e mbetura nga ato të mëparshme. Kredia e shlyer në vitin 2011 në Raiffeisen Bank, me anë të depozitimit cash, datë 02.08.2011, ka si burim financiar një kredi tjetër të përfituar në një bankë, të cilën nuk e kujton ekzaktësisht.
- ✓ **Subjekti dha shpjegime lidhur me kreditë e mësipërme konsumatore.**

- ✚ **Procredit Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023 konfirmon se shtetasi Luan Mema ka pasur llogari në Usd, aktive gjatë periudhës 19.04.2005 - 23.12.2010. Evidentohet se në datë 19.04.2005, është kredituar shuma 5.587 usd nga M.F, tërhequr cash nga Luan Mema në datë 22.04.2005. Gjithashtu në datën 13.12.2005 është kredituar shuma 2.393 usd (transfertë ndërkombëtare ku nuk përcaktohet transferuesi i fondeve), tërhequr cash nga Luan Mema, më datë 31.12.2005.
- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se në vitin 2005 ka pasur llogari në Usd, në Bankën Procredit. Në datën 19.04.2005, shtetasja M.F, e cila ka qënë bashkëjetuesja e shtetasit A.A, i biri i R.A dhe H.A, që jetonte në Angli, ka dërguar shumën prej 5.587 usd dhe më datë 13.12.2005, shumën 2.393 usd. Prindërit e A.A, R.A dhe H.A, të cilët i ka komshinj në Lagjen ***, Durrës, i kanë kërkuar t'i ndihmonte nëse kishte llogari bankare, që t'i mundësonte djalit të tyre A.A dërgimin e fondeve, me qëllim pagesën e punimeve, si dhe blerjen e materialeve për ndërtimin e shtëpisë së tyre. Në rastin konkret, fondet nga Anglia janë dërguar nëpërmjet bashkëjetueses së tij, pasi ky i fundit, A.A, nuk kishte dokumenta të rregullta në Angli. Të dy transfertat janë bërë nga Anglia. Shumat të cilat i ka tërhequr cash në datat 22.04.2005 dhe 31.12.2005, ja ka dhënë shtetasve R.A dhe H.A.

Subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. rep. ***, nr. kol. 105, datë 23.01.2024, e shtetasve R.A dhe H.A, të cilët deklarojnë se janë prindërit e A.A, i cili në vitet 2000 - 2008 ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar pa letra/dokumenta. Duke qënë se ata kishin nevojë për të mbular shpenzimet, ai i ka dërguar shpesh vlera monetare për këtë qëllim. Në datë 19.04.2005, në llogarinë e Luan Mema në Procredit Bank, është transferuar shuma 5.587 usd, nga ish bashkëjetuesja e djalit M.A. Po ashtu është transferuar edhe vlera 2.393 usd. Këto transfertat janë kryer në llogarinë e Luan Mema, për shkak se ata nuk dispononin llogari të tyre bankare. Shumat e mësipërme janë tërhequr cash nga Luan Mema dhe i janë dhënë atyre dorazi. Bashkëlidhur ID të A.A, R.A dhe H.A

- Deklaratë e shtetasit A.A, i cili konfirmon transaksionet e mësipërme të kryera nga ish bashkëjetuesja e tij, M.F, me qëllim dhënien e këtyre fondeve prindërve për ndërtimin e shtëpisë në Durrës.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer verifikim lidhur me shtetasin A.A dhe shtetasen M.F, pranë Policisë së Shtetit, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna në ngarkim të tyre.

✓ **Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues, lidhur me transaksionet e konfirmuara nga Procredit Bank.**

✚ **Unioni Financiar Tiranë**, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023 konfirmon kryerjen e transaksioneve në vijim:

- Luan Mema mbërritur 5 transaksione me vlerë totale 520 euro.
- Ardiana Mema mbërritur 1 transaksion me vlerë totale 645 euro dhe 1 me vlerë 8.000 lekë. Në dalje 1 transaksion me vlerë 500 euro.
- Viola Mema mbërritur 18 transaksione me vlerë totale 5.071 euro. Në dalje 9 transaksione me vlerë totale 3.515 euro dhe dy me vlerë 9.500 lekë.
- Arbër Mema mbërritur 4 transaksione me vlerë totale 1.548 euro dhe dy me vlerë 30.821 lekë.

✚ **AK Invest**, me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023 konfirmon kryerjen e transaksioneve në vijim:

- Luan Mema mbërritur 2 transaksione me vlerë totale 350 euro nga A.V (viti 2018).
- Ardiana Mema mbërritur 1 transaksion me vlerë totale 120 euro (viti 2018) dhe 1 me vlerë 1.114 euro (viti 2022).
- Viola Mema mbërritur 8 transaksione me vlerë totale 4.100 euro dhe 6 me vlerë 231.000 lekë (viti 2018 - 2022). Në dalje 2 transaksione me vlerë totale 3.940 euro dhe 1 me vlerë 10.000 lekë (viti 2020 - 2021).
- Arbër Mema mbërritur 2 transaksione me vlerë totale 972 euro (viti 2021 - 2022).

✚ **Easy Pay**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.08.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema rezulton përfituese në tre transfertat ndërkombëtare, në vlerat totale 20.160 lekë dhe 5.436 euro,

- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se nuk i kujtohen dërguesit lidhur me konfirmimin nga UFT për transaksionet mbërritur në emër të tij, në vlerën 520 Euro, por thekson se në vitin 2019 (datë 01.10.2019 dhe 12.11.2019), ka kryer një ndërhyrje pranë Spitalit Universitar të Traumës Tiranë dhe mendon se këto shuma do jenë kryer nga njerëzit e afërm, që ndodhen jashtë vendit.

Transaksioni i mbërritur bashkëshortes Ardiana Mema, në vlerën 645 euro dhe 8.000 lekë janë dërguar nga djali, Arbër Mema, në Island dhe janë përdorur për shpenzime jetese. Transferta kryer prej saj me vlerë 500 euro, i është dërguar nga shtetasit E.M (djali i vëllait të subjektit) me vendbanim në Itali. Shuma ishte marrë borxh më përpara prej tyre.

Lidhur me transaksionet në vlerën 350 euro, konfirmuar nga AK Invest dërguar nga A.V, Itali, në vitin 2018, sqaroi se janë shuma që kjo shtetase i ka dhuruar për shkak të korrektimit që subjekti i ka kryer tre librave të botuar prej saj.

Lidhur me transaksionet e mbërritura tek Viola Mema, në vlerë totale 5.071 euro dhe në dalje me vlerë totale 3.515 euro, konfirmuar nga UFT, sqaroi se këto transaksione kanë qënë vetëm në kuadër të marrëdhënies së punës, konsulencë fizike dhe online. Nga viti 2018 - 2022 në periudha të ndryshme kohore, Viola Mema ka punuar si specialiste (konsulence fizike dhe online), tek kompania maqedonase “NESTA 2000” dhe “Ritello”. Këto kompani kanë qënë të bashkuara dhe më pas janë ndarë. Gjatë kohës që ka punuar tek kompania “Ritello” me drejtues shtetasin A.U, e cila ushtronte funksion në fushën e pastrimit të ujit, të gjitha transaksionet janë kryer tek personat e tretë, për të cilat kompania e adresonte, për blerjet e produkteve, filtrave, depozitave dhe shërbimeve të ndryshme që kryente kompania.

Gjithashtu ka bërë transaksione edhe për llogari të kompanisë “NESTA 2000” me drejtues shtetasin E.M, për shërbimet që kjo kompani kryente në mirëmbajtjen e filtrave të ujit dhe shërbimeve të cilat mbulonte.

Lidhur me transaksionet e mbërritura në vlerë totale 4.100 euro + 231.000 lekë (viti 2018 - 2022), si dhe transaksionet në dalje me vlerë totale 3.940 euro (viti 2020 - 2021), konfirmuar nga AK Invest, subjekti sqaron se kanë qënë për llogari të kompanisë “NESTA 2000”, për blerje materiale, riparimesh, me ndërmarrjet që kompania mbulonte kur kryente punime, si dhe blerje depozitash e pagesa punëtorësh mirëmbajtje. Transaksionet e mbërritura në Ak Invest, me vlerë 972 euro, nga shtetasi Sh.K, janë përdorur për blerje furnizim mallra të dyqanit që ky shtetas ka në Durrës.

Lidhur me transfertat e mbërritura ndërkombëtare me vlerë totale 5.436 euro konfirmuar nga Easy Pay, për Viola Mema, sqaron se kanë qënë për llogari të kompanive të mësipërme. Në lidhje me transaksionet e mbërritura ndaj shtetasit Arbër Mema, në vlerën 1.548 euro dhe 9.200 lekë, janë bërë nga shtetasit: Viola Mema, shuma 700 euro, për udhëtimin e tij në Islandë; D.SH, shuma 100 euro, dhuratë nga vajza tezes; Xh.M, shuma 98.15 euro, për blerje veshje në një dyqan në Durrës për Xh.M; M.H shuma 650 euro, për blerje veshje në Durrës dhe për t'ja dërguar në Itali, MH-së; S.D, shuma 9.200 lekë, për ti paguar një gjobë në policinë e Durrësit, e cila ishte në emër të S.D.

- **Në kthim përgjigjen nr. ***, datë 20.06.2024 dhe nr. ***, datë 08.08.2024**, pranë Trupës së Vlerësimit, subjekti sqaroi, se vajza ka punuar me kohë të pjesshme për kompanitë Ritello dhe NESTA 2000 dhe nuk disponon dokumentacion, pasi këto veprime janë bërë për blerje dhe shlyerje të materialeve për llogari të kompanive. Të ardhurat e përfituara kanë qënë rreth 15.000 - 20.000 lekë/muaj. Gjithashtu subjekti ka sqaruar se nuk e ka të mundur të krijojë kontakt me drejtuesit e kompanive Ritello dhe NESTA 2000 për të marrë një deklaratë prej tyre, pasi aktualisht nuk ka komunikim me vajzën e tij e cila ndodhet në Angli, ku po merr mjekim për problemim shëndetësor e psikologjik.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim nr. ***, datë 25.01.2024, nga Spitali Universitar i Traumës, për Luan Mema, i cili ka qënë i shtruar pranë këtij spitali, gjatë periudhave 30.09.2019 - 01.10.2019 dhe 11.11.2019 - 12.11.2019.
- Deklaratë noteriale nr. rep., ***, nr. kol., ***, datë 23.01.2024, e shtetases A.V, e cila deklaroi se në vitin 2018 i ka dërguar shtetasit Luan Mema, një vlerë prej 350 euro nga shteti italian, me anë të Money Gram.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer verifikime pranë Policisë së Shtetit, për të gjithë shtetasit të cilët kanë kryer transaksione me Viola Mema si dërgues/marrës, nga ku ka rezultuar se nuk ka informacione në ngarkim të tyre.

Bazuar në konfirmimet e mësipërme nga UFT, AK Invest dhe Easy Pay, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, në mënyrë të permbledhur rezultojnë se;

Subjekti, bashkëshortja dhe djali kanë kryer transfertat në mbërritje dhe dalje, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime, si dhe ka paraqitur dokumentacion.

Lidhur me transfertat e kryera nga vajza, e cila rezultojnë se ka tërhequr për periudhën 2018 - 2022, shumën totale prej 14.607 euro + 231.000 lekë, si dhe ka dërguar shumën totale 7.455 euro, subjekti ka dhënë shpjegime se kryesisht, i përkasin marrëdhënieve të saj të punësimit part time, konsulentë online. Nuk është paraqitur dokumentacion i justifikues, në mbështetje të sqarimeve lidhur me origjinën e transaksioneve të mbërritura, qëllimin e përfitimit të tyre dhe destinacionin/qëllimin e dërgesave.

✓ **Sa më sipër, subjekti ka dhënë shpjegimet, lidhur me konfirmimet nga UFT, AK Invest dhe Easy Pay gjatë periudhës 2018 – 2022.**

✚ **NOA**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.08.2023 konfirmon se shtetasi Luan Mema, identifikohet si garantues në kredinë e shtetasit R.S, marrë më 31.05.2013, në shumën 317.200 lekë. Kredia rezultojnë e likuiduar në datën 10.06.2016.

• **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se me shtetasin R.S ka punuar në Polici, në vitet 1998 - 2000 dhe ka marrëdhënie miqësore e familjare. Nuk ka kontribuar financiarisht në shlyerjen e kredisë së shtetasit R.S, thjesht ka qënë garantues sipas procedurave që kërkonte banka.

Subjekti qaraqiti:

➤ Deklaratë e shtetasit R.S, datë 22.01.2024, i cili deklaron se me shtetasin Luan Mema kanë një marrëdhënie shoqërore e familjare. Në vitin 2013 ka marrë një kredi me vlerë 317.200 lekë nga banka NOA, në të cilën kërkohet një person dorëzanës dhe për këtë qëllim e ka ndihmuar shtetasi Luan Mema. Detyrimet e kësaj kredie janë shlyer totalisht prej tij, deri në likuidimin total të kredisë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer verifikim lidhur me shtetasin R.S, pranë Policisë së Shtetit, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna në ngarkim të tij.

✓ **Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues lidhur me konfirmimin e institucionit financiar NOA.**

- ✚ **Iute Credit**, me shkresën nr. *** prot., datë 21.03.2024, konfirmon se Viola Mema, ndër vite ka marrë kredi, të cilat pjesërisht rezultojnë të mbyllura dhe pjesërisht aktive (me vonesë).
Kredi të shlyera; datë 17.08.2020, vlera 152.000 lekë; datë 20.10.2020, vlera 60.000 lekë; datë 28.12.2021, vlera 100.000 lekë; datë 01.02.2022, vlera 110.000 lekë.
Kredi aktive (të pashlyera e me vonesë): datë 30.05.2022, vlera 199.505 lekë; datë 02.06.2022, vlera 199.875 lekë; datë 14.06.2022, vlera 19.988 lekë.
- ✚ **Kredo.al**, me shkresën nr. *** prot., datë 02.08.2023, konfirmon se shtetasja Viola Mema, më datë 23.07.2018 ka përfituar kredi me vlerë 7.500 lekë, për të cilën ka shlyer totalisht detyrimet.
- ✚ **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***, dt. 14.8.2023 konfirmon se, shtetasi Luan Mema ka pasur në pronësi të tij, automjetin me targë ***, i cili figuron në statusin çregjistrim i përhershëm.
Bashkëlidhur:
 - Kontratë blerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.1996, nënshkruar ndërmjet palës shitëse P.H dhe palës blerëse Luan Mema, të automjetit tip Fiat Uno, nr. shasie ***. Çmimi i shitjes 300.000 lekë, është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Shtetasja Viola Mema ka të regjistruar në emër të saj, automjetin me targë *** dhe ka pasur të regjistruar automjetin me targë *** (***).
 - Kontratë blerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.05.2022, nënshkruar ndërmjet palës shitëse F.Sh dhe palës blerëse Viola Mema, të automjetit tip Daimler Chrysler C220CDI, targë ***. Çmimi i shitjes 5.000 euro, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
 - Kontratë shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.05.2022, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Viola Mema dhe palës blerëse F.Sh, të automjetit tip Audi A4, targë ***. Çmimi i shitjes 5.000 euro, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
 - Kontratë blerje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2021, nënshkruar ndërmjet palës shitëse M.D dhe palës blerëse Viola Mema, të automjetit tip Audi A4, targë ***. Çmimi i shitjes 4.000 euro, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- **Me inventarin e datës 26.01.2024**, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti sqaron se nuk i kujtohej automjeti me targa *** në emër të tij, në momentin e deklarimit; automjetin e ka lënë në pikën e grumbullimit të makinave të nxjerra jashtë funksionit dhe me çregjistrimin e tij duhet të jenë marrë personat e kësaj qëndre.
Lidhur me mosdeklarimin e automjetit me targë ***, në pronësi të vajzës, Viola Mema, sqaron se ka ndodhur pikërisht për arsye të aksidentit që ajo kishte pësuar të cilat i kanë shkaktuar rëndesë psikologjike e mendore. Burimi financiar për blerjen e automjetit Audi në vitin 2021, është kredia e marrë pranë Institutit Financiar NOA, me vlerë 638.500 lekë, kurse burimi financiar për blerjen e Automjetit Daimler Chrysler C220 CDI, në vitin 2022, është nga shitja e automjetit Audi të mëparshëm.
Kredia është përdorur pjesërisht për blerjen e një automjeti Audi A4 dhe pjesën e mbetur e ka investuar më vonë në aktivitetin e saj tregtar. Trajtuar më lartë.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe nga hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

Në vitin 1996, subjekti blen automjetin tip Fiat Uno, me vlerë 300.000 lekë (në vitin 1995, ka shitur automjetet IFA dhe Audi, në total 800.000 lekë). Subjekti ka dhënë sqarime se blerja dhe çregjistrimi i automjetit, nuk janë deklaruar prej tij, për shkak të harresës në momentin e plotësimit të deklaratës. Gjithashtu deklaroi se çregjistrimi i mjetit nuk është kryer prej tij.

Lidhur me konfirmimin e automjeteve në emër të vajzës, rezultoi se në vitin 2021, Viola Mema blen automjetin Audi A4, në vlerën 4.000 euro, me burim kredinë në NOA, me vlerë 638.500 lekë dhe e shet në vitin 2022, në vlerën 5.000 euro. Po në vitin 2022, blen automjetin Daimler Chrysler C220 CDI, në vlerën 5.000 euro, me burim shitjen e automjetit Audi A4. Veprimet e shitblerjes së automjetit Audi A4, si dhe automjetit aktual me targë ***, nuk janë deklaruar nga vajza e subjektit, për shkak të problemeve shëndetësore dhe psikologjike të saj.

- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me automjetin Fiat Uno, me targa LA4021, blerë në vitin 1996 në vlerën 300.000 lekë, me status çregjistruar.**

Sa më sipër, rezultoi:

- ❖ **Mosdeklarim i automjetit Daimler Chrysler, në emër të Viola Mema, blerë në vitin 2022, në vlerën 5.000 euro, si dhe i transaksioneve të shitblerjes së automjetit Audi me targë ***, blerë në vitin 2021, me vlerë 4.000 euro dhe shitur në vitin 2022 me vlerë 5.000 euro, mosdeklarime të cilat, sipas shpjegimeve të subjektit kanë ardhur si pasojë e problemeve shëndetësore, të cilat i ka dokumentuar me dokumentacionin mjekësor përkatës.**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën *** prot., datë 04.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të Luan Mema dhe personave të lidhur me të.

- ❖ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;
- Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 06.03.2023, është deklaruar bruto 5.419.739 lekë + 6.800 Euro, e konvertuar rreth 6.195.000 lekë dhe neto rreth 3.940.000 lekë.
- Të ardhurat familjare nga paga, shpërblime, etj., për periudhën 1997 - mars 2023, janë në vlerën totale rreth 21.428.000 lekë.
- Të ardhurat neto nga qiradhënia e pasurisë së paluajtshme, për maj 2008 – janar 2012, janë në vlerën totale rreth 1.544.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar dhe përdorur si burim:

- Të ardhura nga shitja e tokës arë të bashkëshortes, në shumën 75.000 lekë.
 - Të ardhura nga emigracioni i djalit në Island, në shumës 1.189 euro.
 - Kredi në RFZ Bank, për periudhën 2005 – 2023, në shumën totale rreth 7.809.000 lekë, nga të cilat rreth 4.449.000 lekë, kanë shërbyer për shlyerjen e detyrimeve të mbetura të kredive të mëparshme. Detyrimi financiar 1.429.879 lekë.
 - Kredi në BKT, marrë në vitin 2012, shuma 700.000 lekë. Shlyer.
 - Kredi në Procredit Bank, periudha 2005 – 2008, në shumën totale 570.000 lekë. Shlyer.
 - Kredi në Fondin Besa, periudha 2007 – 2008, në shumën totale 600.000 lekë. Shlyer.
 - Kredi në NOA, periudha 2021 – 2022, në emër të vajzës, në shumën totale 1.138.000 lekë. Detyrimi financiar 825.175 lekë.
- Për periudhën janar 2000 - mars 2023, referuar treguesve statistikore të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 15.700.000 lekë. (nuk përfshihen shpezimet për konsum të djalit, gjatë kohës së qëndrimit të tij në Island).
 - Për periudhën deri në 06.03.2023, janë shpenzuar për mobilim, në total rreth 515.000 lekë.
 - Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon, internet etj, në total rreth 170.000 lekë.
 - Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime, të subjektit dhe familjarëve, në vlerën totale 1.200 euro, konvertuar rreth 137.000 lekë.
 - Për periudhën deri në datën 06.03.2023, janë shpenzuar për arsimin e djalit shuma 1200 euro, konvertuar rreth 137.000 lekë.
- ❖ Lidhur me vajzën e subjektit, Viola Mema, rezultojnë mosdeklarime dhe mungesë dokumentacioni justifikues, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime se kanë ardhur si pasojë e problemeve shëndetësore dhe psikologjike, më poshtë si vijon:
 - Lidhur me transaksionet e konfirmuara nga UFT, AK Invest, Easy Pay gjatë periudhës, 2018 – 2022, në emër të Viola Mema, nga hetimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, nuk u administruan prova të cilat çënojnë kriterin e pasurisë.
 - Referuar të gjitha transaksioneve të kryera nga Viola Mema, si marrësë dhe dërguese, janë kryer verifikime pranë Policisë së Shtetit, lidhur me të gjithë personat me të cilët janë kryer transaksionet, nga ku ka rezultuar se nuk kanë të dhëna në ngarkim të tyre.
 - Mosdeklarimi i automjetit tip Daimler, blerë në vitin 2022 si dhe i shit/blerjes së automjetit tip Audi, blerë në vitin 2021 dhe shitur në vitin 2022. Lidhur me mundësinë financiare, trupa ka konstatuar se blerja e automjetit tip audi ka si burim krijimi kredin e marrë nga Viola Mema tek Noa, në vitin 2021. Ndërsa si burim krijimi për automjetin tip Daimler, ka shitjen e automjetit Audi në vitin 2022. Mosdeklarimi i veprimeve të mësipërme, sipas shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar nga Trupa e Vlerësimit, ka ardhur si pasojë e

probleme shëndetësore dhe psikologjike të vajzës së subjektit Viola Mema, shkaktuar nga një aksident që i ka ndodhur përpara plotësimit të deklaratës së pasurisë, problem për të cilin po kurohet jashtë vendit.

- Subjekti ka sqaruar se vajza e tij, nuk ka jetuar pranë familjes që prej vitit 2016, vit në të cilin ajo është shpërngulur në Tiranë, ku ka jetuar me familjen e shtetases R.SH e cila ishte mikeshë e Viola Mema. Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të shtetases R.Sh e cila konfirmon se Viola Mema ka jetuar në familjen e znj. Shahini që prej vitin 2016, ku ka bashkëngjitur dhe dokumentacionin lidhur me apartamentin.
- Nga verifikimet në sistemet e policisë, Trupa e Vlerësimit, ka konfirmuar deklarin e subjektit se vajza e tij jeton jashtë vendit. Gjithashtu nga verifikimet, ka rezultuar se automjeti i cili është në pronësi të Viola Mema, aktualisht përdoret nga shtetasi S.K, për të cilin është kryer verifikim pranë Policisë së Shtetit nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna në ngarkim të tij.

🚩 Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Luan Zylal Mema:

- ✓ *Ka bërë deklarin të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;*
- ✓ *Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *Nuk është kryer fshehje e pasurisë;*
- ✓ *Nuk është kryer deklarin i rremë;*
- ✓ *Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interes.*

B. KONTROLI I FIGURËS

🚩 Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

🚩 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;

2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Luan Mema, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikimit nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës” të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit Z. Luan Mema në zbatim të nenit 36, pika 1, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- b. Raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 03.01.2024, të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ **Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit**, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e hollësishëm mbi kontrollin e figurës, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 03.10.2023, ku ka konstatuar se pwr:

- a) **Subjektin e vlerësimit z. Luan Zylal Mema, me detyrë Zv/Drejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk ka pasur emër dhe mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër dhe mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar.
- Nuk ka pasur nënshtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Ka qënë në hetim/gjykim nga autoritetet shqiptare, për kryerjen e një vepre penale, si më poshtë:
 - a) Procedimi penal, nr. ***, i vitit 2002, nga Prokuroria Ushtarake, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë.

- b) Procedimi penal, nr. ***, i vitit 2005, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të cilën është vendosur pushim i akuzës.
- Nuk ka qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një veprë penale.
 - Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale
 - Ndaj tij nuk është lëshuar ndonjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
 - Nuk ka marrë ndonjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
 - Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes suaj është përfshirë/dyshohet për përfshirje në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
 - Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
 - Nuk ka dijeni që një nga anëtarët e familjes ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë/dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
 - Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
 - Nuk ka dijeni se një anëtar i familjes ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë/dyshuar për përfshirje krimin e organizuar.
 - Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, gjatë 10 viteve të fundit.
 - Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - Nuk ka pasur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
 - Nuk ka fshehur apo keqtrajtuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
 - Nuk ka kryer shkelje sigurie apo nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së infomacionit të klasifikuar si dhe as tentuar apo kryer aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
 - Nuk ka qënë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit.

Subjekti ka nënshkruar dy vetëdeklarime për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, me shkresën nr. *** prot. datë 07.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Mema, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresën nr. *** prot. datë 28.07.2023, bën me dije se subjekti i vlerësimit Z. Mema, nuk rezulton i dënuar.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 08.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Mema, nuk disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo në veprimtari të kundraligjshme.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 11.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Mema, nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen e tij në aktivitete e tij në aktivitete të kundërligjshme.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 07.08.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Mema, nuk figurojnë informacione të regjistruara për veprimtari kriminale.
- ✚ **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën e datën 16.08.2023, shkresën nr. *** prot. datë 07.08.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 03.10.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Mema nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm dhe nuk ka procedime penale të referuara.
- ✚ **Institucionet ligjzbatues**, me shkresën nr. *** prot. datë 10.08.2023 dhe shkresën nr. *** prot. datë 27.09.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Mema nuk është nxjerrë urdhër ndalimi, nuk është kërkuar masë e sigurimit personal (masa shtrënguese/masa parandaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- Në përgjigjet e kthyera prej saj, cituar më sipër, Institucioni ligjzbatues, nuk ka konfirmuar asnjë të dhënë në ngarkim të subjektit, por në Deklaratën e Kontrollit të Figurës, është konstatuar se subjekti i vlerësimit Z. Luan Mema ka deklaruar si më poshtë:
 - a) Prokuroria Pranë Gjatës së Shkallës së Parë, e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2002, në ngarkim të Luan Mema, i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës nga ushtaraku”, parashikuar nga neni 70/1 I Kodit Penal Ushtarak.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka paraqitur Vendimin nr. ***, datë 15.10.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku në përfundim të hetimeve ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Luan Zylal Mema”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Ushtarak Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.12.2002.

Kundër vendimit të Gjykatës së Lartë të Apelit Ushtarak, është berë rekurs në Gjykatën e Lartë, rekurs i cili është refuzuar me vendimin nr. ***, datë 18.04.2003.

- b) Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2005, në ngarkim të subjektit Luan Mema, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e akteve të përcjella nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka paraqitur Vendimin e Prokurorit të çështjes, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, datë 17.03.2006, i cili ka vendosur “Pushimin e akuzës”, në ngarkim të subjektit Luan Mema.

✚ **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, më shkresën nr. *** prot. datë 31.07.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Mema, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin "Tepër Sekret" lëshuar me datë 23.11.2018, e vlefshme deri më datë 22.11.2023. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

- Referuar përgjigjes së AKSIK, Certifikata e Sigurisë së Personelit (CSP), e subjektit të vlerësimit Z. Luan Mema, ka pasur vlefshmëri deri në datën 23.11.2018. Për këtë arsye Trupa e Vlerësimit, i është drejtuar Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, pranë AMP-së, lidhur me statusin aktual të CSP-së për Z. Mema, të cilët me përgjigjen e datës 04.10.2024, kanë konfirmuar se subjekti i vlerësimit, është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin "Tepër Sekret" lëshuar me datë 23.11.2023, e vlefshme deri më datë 22.11.2028.

✚ **Avokati i Popullit**, me shkresën nr. *** prot. datë 14.08.2023, se për subjektin e vlerësimit Z. Mema, nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës si dhe nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën nr. *** prot. datë 24.11.2023, se subjekti i vlerësimit Z. Mema, nuk ka qënë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

✚ **Në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**, për subjektin e vlerësimit Z. Mema, nuk ka denoncime nga publiku dhe nuk disponohen ankesa për të.

✚ **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë, ka kryer në datën 09.01.2024, testin mbi përdorim ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara nga Ekzaminimi Toksikologjiko – Ligjor, për

përdorim lëndësh narkotike, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore nr. *** datë 11.01.2024, konkludohet se subjekti vlerësimi **Z. Luan Zylal Mema**

➤ **Akualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.**

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Luan Zylal Mema:

- ✓ ***Ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***
- ✓ ***Nuk ka informacion në deklarament të tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikqyrjes Policore”.

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

✚ Subjekti i vlerësimit Z. Luan Mema më datë 06.03.2023, ka dorëzuar në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

- ✚ Në dispozitën e Nenit 44, pika “2” dhe “3” të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, është përcaktuar se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet” dhe “Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban , periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës”.
- ✚ Subjekti i vlerësimit **Z. Luan Mema** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Zv/Drejtorit për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat
- ✚ Struktura e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka dorëzuar raportin e vlerësimi profesional, të subjektit të vlerësimit, nr. *** prot., datë 11.08.2023, ku në konkluzionin përfundimtar, shprehet se:
 - a) **“Punonjësi i policisë z. Luan Zylal Mema është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

Hetimi Administrativ

- Trupa e Vlerësimit, në mbështetje të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe bazuar në të dhënat e administruara në dosjen e subjektit të vlerësimit, të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, ka kryer hetimin e plotë mbi aftësitë profesionale të subjektit të vlerësimit, **nga ku është konstatuar si më poshtë:**

1. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2, gërma a, e Ligjit 12/2018, të ndryshuar.

Në Formularin e Aftësive Profesionale të plotësuar nga subjekti ka rezultuar se ka kryer studimet si më poshtë:

- 1997 – 2000 – Arsimin e Lartë, pranë Akademisë së Policisë, Specialist i Lartë i Policisë.
- 2010 – 2013 – Arsimin e Lartë, pranë Universitetit privat Albanian University, në Shkenca Juridike.

- 2014 – 2018 – Master Shkencor, pranë Kolegjit Universitar BEDER, dega E Drejtë Penale.

Hetimi Administrativ

Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit ka rezultuar:

- Kopje e Diplomës së Shkollës së Lartë, në Akademin e Policisë, nr. ***, datë 28.09.2000, në titullin Specialist i Lartë Policie.
- Kopje e Diplomës Bachelor në Shkenca Juridike, Universiteti privat Albanian University, nr. ***, datë 27.07.2013.
- Kopje e Diplomës Master i Shkencave, dega E Drejtë Penale, në Kolegjin Universitar BEDER, datë 09.05.2018.

Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar rezulton se subjekti i vlerësimit, për periudhën e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, sipas ecurisë së tij në karrierë, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar në vite dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

2. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, përcaktohet se: “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet”.

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është ecuria në karrierë dhe fitimi i gradave, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Subjekti i vlerësimit Luan Mema, ka një karrierë në Policisë e Shtetit prej 18 vitesh e 10 muaj. Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- Nga data 22.02.2016 deri më 01.05.2018, ka kryer detyrën e Specialistit në Sektorin për Krimet e Pronës, në Drejtorin për Krimet, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Nga data 01.05.2018 deri më 19.05.2021, ka kryer detyrën Specialistit në Sektorin për Krimin Ekonomik, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

- Nga 19.02.2021 deri më 06.07.2023, ka kryer detyrën e Shefit të Sektorit në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorin Vendore të Policisë Durrës.
- Nga data 06.07.2023 dhe aktualisht, ka kryer detyrën e Zv/Drejtorit për Sigurinë Publike, në Drejtorin Vendore të Policisë Berat.

Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit ka përfituar gradat policore si më poshtë:

- **Grada Kryekomiar** sipas urdhrit nr. ***, datë 02.06.2014 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- **Grada Drejtues** sipas urdhrit nr. ***, datë 12.08.2022 “Për dhënien e gradës policore, transferimin dhe emërimin e një punonjësi policie”, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Pas kontrollit dhe verifikimit me dokumentacionin e sipërpërmendur, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Z. Luan Mema, arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

3. Vlerësimet e punës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë vlerësimet e punës, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Në dosjen personale të subjektit të vlerësimit për periudhën 2018 – 2022, janë administruar 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës. Nga administrimi i këtyre akteve, rezulton se gjatë 5(pesë) viteve të fundit, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga punëdhënësit për rezultate individuale të punës me vlerësimin “Shumë Mirë”.

Vlerësimet përkatëse si vijon:

▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021	27 Pikë	(shumë mirë)
▪ Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022	100 Pikë	(shumë mirë)

Avokati i Popullit, me shkresën nr. *** prot. datë 14.08.2023, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Luan Mema.

Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime apo ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Bazuar në vlerësimet e sipërmendura, të administruara në dosjen personale të subjektit, arrihet në konkluzionin se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale dhe funksionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë n kryerjen e detyrave funksionale.

4. Respektimi i rregullave të etikës:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë masat disiplinore, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma d, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Nga verifikimi në dosjen personale dhe sistemin RMIS, rezultoi se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, (2018 - 2023), subjekti i vlerësimit Z. Luan Mema, nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes personale, bazuar në vlerësimet e aftësive individuale të punës nga eprorët ndër vite, në lidhje me respektimin e rregullave të etikës, ka rezultuar se: subjekti shfaq integritet dhe standarde të larta etike, është shembull i mirë për organizatën.

Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

5. Kualifikimet dhe trajnimet:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale janë certifikatat e trajnimeve dhe medaljet, sipas parashikimit të nenit 45 pika 2, gërma c, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Hetimi Administrativ

Nga verifikimi dosjes personale si dhe pikës 3 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se gjatë periudhës 5 (pesë) vjeçare, është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, si më poshtë:

- Trajnim në vitin 2017, Qasja e agjensive internacionale ndaj krimit dhe ambientit;
- Trajnim në vitin 2017, Të kuptojmë legjislacionin e krimit ndaj ambientit;
- Trajnim në vitin 2019, Kurs trajnimi për investigim;
- Trajnim në vitin 2020, Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare;
- Trajnim në vitin 2021, Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet dispozitave penale dhe praktika e vendit tonë në këtë fushë.

Trajnimet dhe pajisja me çertifikata trajnimi është kryer gjatë ushtrimit të detyrës së tij si punonjës i strukturës dhe se ato janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyra të ndryshme ku ka punuar.

Nga verifikimet e kryera arrihet në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë.

6. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, botime.

Subjekti i vlerësimit Z. Luan Mema, në Formularin e Aftësive Profesionale, ka deklaruar se për periudhën objekt vlerësimi, nuk është angazhuar në Konferenca Shkencore, Workshope, Seminare, Botime, brenda dhe jashtë vendit.

Në përfundim, Trupa e Vlerësimit, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, neni 46, arriti në konkluzionin se:

Deklarimi i subjektit është në përputhje më verifikimet e kryera.

🚩 Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Luan Zylal Mema:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Luan Zylal Mema, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Luan Zylal Mema** me funksion Zv/Drejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 31.10.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesues

Denisa SINA

Relator

Suela BULKU

Anëtar

Arben SEFAJ